AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë "Bachelor"**

**"Mësuesi për Arsimin Parashkollor"**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**"Ismail Qemali" Vlorë**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Dilina Beshiri
2. Dr. Leticja Gusho


Prill/2021

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për Programin e studimit: Programi i studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"**

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti 'Ismail Qemali" Vlorë |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Edukimit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | Shkresë MASh Nr. 643/1 Prot, datë 17.06.2002 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | UMASh Nr. 439, datë 09.09.2011 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite/ 6 semestra |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 kredite |
| 11 | Forma e studimit: | Kohë e plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 14 PAE/ 2PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | 76 |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Procesi respektiv i vlerësimit, duke u bazuar në rradhë të parë në aktivitetet e realizuara sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet, është realizuar në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Ismail Qemali", Vlorë. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të parë "Bachelor", me emërtesë "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" i ofruar nga Departamenti i Edukimit. Ky departament është pjesë e Fakultetit të Shkencave Humane të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Programi është hapur me Shkresë MASH nr.643/1 Prot, datë 17.06.2002, me emërtimin "Mësues për Arsimin Parashkollor", me kohëzgjatje 3 vjet.

Sipas Urdhërit të MASH nr.439, datë 09.09.2011, mënyra e regjistrimit të diplomës është "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".

Programi i studimit nuk ka kaluar më parë proces akreditimi.
Ky program i ciklit të parë "Bachelor" përmban gjithsej 180 ECTS dhe është me kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program ndër vite ka qenë:

- Për vitin akademik 2020-2021 është 9 studentë
- Për vitin akademik 2019-2020 është 11 studentë
- Për vitin akademik 2018-2019 ka qënë 15 studentë
- Për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 41 studentë

Ky program studimi akreditohet për herë të parë.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

*Metodologjia e përdorur për realizmin e vlerësimit të jashtëm*

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm ka qënë identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr.531, datë 11.09.2018, për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor". ASCAL bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, për të realizuar takimet në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr.Dilina Beshiri dhe Dr.Leticja Gusho. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua edhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc.Aviola Bardhi.

***Baza ligjore mbi të cilin është mbështetur procesi i vlerësimit të jashtëm* është:**

- Ligji nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"
- Urdhër i MASH nr.81, datë 25.02.2013
- VKM nr.531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e kodit të cilësisë së arsimit të lartë"
- Manuali për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, ASCAL 2017.

***Aktivitetet kryesore të realizuara***

Në kuadër të këtij vlerësimi janë realizuar disa aktivitete. Kështu, është realizuar analiza e të dhënave parësore dhe dytësore.

**Analiza e të dhënave parësore**. Të dhënat parësore janë ekstraktuar nga:

- raporti i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të ciklit të parë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" (2020) i realizuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm;
- statuti i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
- rregullore e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë;
- rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane;
- paketa e plotë e dokumentacionit të programit;
- programet lëndore;
- dokumentacione të tjera administrative, siç është dokumentacioni i personelit.

**Analiza e të dhënave dytësore**. Kjo analizë u mbështet në të dhënat e marra nga takimet e realizuara me anë të Platformës Zoom. Si rezultat i shtrirjes së efektit të Pandemisë prej COVID-2019, si edhe në kuadër të zbatimit të protokollit të përcaktuar nga Komisioni Teknik i Ekspertëve në Republikën e Shqipërisë, si edhe nga aktet normative në fuqi, vizitat e planifikuara në ambjentet e institucionit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë (Fakultetit të Shkencave Humane, Departamentit të Edukimit) nuk u zhvilluan në kushtet e pranisë fizike në institucion, por përmes realizimit të takimeve online si edhe përmes përdorimit të platformave të konsoliduara me format video dhe audio me përdorim të gjërë për këtë qëllim.

Takimet sipas agjendës së paracaktuar dhe të dakordësuar nga të dy institucionet janë zhvilluar në datat 10 dhe 11 Shkurt 2021. Gjatë këtyre takimeve u zhvilluan bashkëbiseda të qëllimta dhe vëzhgime. Kështu, u realizuan biseda të drejtuara me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane, me Përgjegjësin e Departamentit të Edukimit, si edhe me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". Gjithashtu, më pas u realizuan biseda me stafin akademik të programit të studimit, me përfaqësues të Drejtorisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, me përfaqësues të sekretarisë mësimore, me përfaqësues të Drejtorisë së Komunikimit dhe Burimeve Njerëzore, me përfaqësues të Drejtorisë së Edukimit për Ciklin e I& II, si edhe intervista me studentët e programit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", si edhe u mundësua vëzhgimi i mjediseve (auditorëve, laboratorëve, bibliotekës, si edhe shërbimet për studentët etj.). Në përfundim të takimeve on-line në ditën e dytë, u zhvillua edhe takimi përmbyllës me përgjegjësin e Departamentit të Edukimit.

**Vëzhgimi i mjediseve**

Siç u cilësua më sipër, si rezultat i pandemisë prej COVID-19, vizitat në institucion nuk janë realizuar në prezencë fizike. Stafi i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, i angazhuar për këtë proces, ka patur gjatë gjithë kohës një përkushtim maksimal për t'i siguruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të gjithë elementët e nevojshëm për ta kaluar këtë pengesë. Kështu, anëtarë të stafit me anë të përdorimit të mjeteve teknologjike audio-vizuale, mundësuan vëzhgime të auditorëve, të sekretarisë, si edhe të ambjenteve të bibliotekës.

Duke u mbështetur mbi analizën e të dhënave të marra nga këto burime është hartuar dhe raporti i vlerësimit të jashtëm.

Më datë 19.03.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare 1/22 prot, datë 19.03.2021 dërgohet në Institucion Draft- Raporti i vlerësimit të jashtëm. IAL përcolli komentet përmes AMS më datë 02.04.2021 dhe me shkresë zyrtare Nr 490/2 Prot, datë 02.04.2021.

**GVJ pasi u njohën me komentet e institucionit mbi Draft- Raportin sqaron si vijon:**

- **STANDARDI V.5**

__Kriteri 2:__ Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

**GVJ ndër të tjera komenton***:* "Ndërsa përsa i përket përfshirjes se studentëve në vendimmarrje e këshillim rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument, që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës".

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Studentët janë në fokus të Strategjisë së Zhvillimit të Institucionit dhe si rrjedhim, angazhimi i tyre në proçeset e vendimarrjes, këshillimit apo vlerësimit të institucionit është i vazhdueshëm. Dokumentat, të cilat dëshmojnë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik dhe Këshillin e Etikës:

- Vendimin e Senatit Akademik nr. 40 datë 29.01.2020 " Për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Etikës në Universitetin " Ismail Qemali", Vlorë"[1]. Në Këshillin e Etikës njëri prej anëtarëve është student.
- Vendimin e Senatit Akademik nr. 79 datë 08. 09. 2020 " Për Kostituimin e Senatit Akademik të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë"[2]. Në Senatin Akademik janë anëtarë dy studentë.

Përveç garantimit të përfaqësisë së studentëve në organet kolegjiale të sipërpërmendura në UV studentët janë dhe pjesë e pandarë e komisioneve të ndryshme Ad-Hoc të ngritur me qëllim hartimin apo përmirësimin e instrumenteve për sigurimin e cilësisë në UV[3],[4],[5],[6],[7] apo komisioneve për përzgjedhjen e fituesve të bursave Erasmus+[8].

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ pasi shqyrtoi dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të UV, konstaton se Vendimi i Senatit Akademik nr. 79 datë 08. 09. 2020 "Për Kostituimin e Senatit Akademik të Universitetit " Ismail Qemali", Vlorë është i njëjtë me vendimin e Vendimin e Senatit Akademik nr. 40 datë 29.01.2020 "Për Përzgjedhjen e Anëtarëve të Këshillit të Etikës në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë"[9]. Në Këshillin e Etikës njëri prej anëtarëve është student.
Në Standardin V.5/2, GVJ reflekton ndryshimin si vijon: Ndërsa përsa i përket përfshirjes së studentëve në vendimmarrje e këshillim rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument, që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik".
*GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

## ❖ STANDARDI VI.1

**Kriteri 3:** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.

***GVJ ndër të tjera komenton:*** "Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë përdorimin e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional."

---

[1] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf
[2] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf
[3] Evidenca VI.5 Urdhër Nr. 123 datë 19.12.2019 ( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[4] Urdhër mbi ngritjen e grupit të punës ad-hoc për pilotimin e pyetësorit të shërbimeve mbeshtetëse.
[5] Evidenca: Studentë të Angazhuar në grupin e punës mbi sondazhin kombëtar të studentëve
[6] Evidenca J- Raporti vjetor i UV-së për vitin 2018-2019, fq 118-119( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[7] Aneks 1: Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJBSC, Pjesë përbërëse e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm.
[8] Evidenca H- Rregullore për implementimin e ICM, neni 12 ( Dorëzuar me Dosjen e Akreditimit)
[9] Vendim Senati nr. 40, datee 29.01.2020, publikuar ne faqen zyrtare te Universitetit: https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2020/02/Vendim-Nr.-40-Dt.-29.01.2020.pdf

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Universiteti "Ismail Qemali", Vlorë, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me ASCAL si personi juridik publik përgjegjës për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë, i kushton një rëndësi të veçantë vlerësimit të jashtëm të cilësisë, nëpërmjet një sërë Instrumentash dhe proçesesh:

- Gjatë muajit Qershor 2020, Institucioni ju nënshtruar proçesit të akreditimit periodik institucional, i cili përfundoi me sukses me një vlerësim pozitiv për një periudhë kohore 5- vjeçare. (Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 50, datë 27. 11. 2020).
- Gjatë periudhës Prill 2019- Prill 2021 përfundoi proçesi i Akreditimit të gjithë programeve të Studimit të Ciklit të Parë UV-së. ( 25 programe studimi)
- Një tjetër mekanizëm i vlerësimit të jashtëm ishte pjesëmarrja aktive e UV-së në **Sondazhin Kombëtar të Studentëve (SKS) të organizuar prej ASCAL** gjatë vitit 2019. Në institucion u ngritën një grupe pune specifike per çdo Njësi Kryesore[10] të cilët ndoqën të gjithë proçesin duke filluar prej ndërgjegjësimit dhe informit të studentëve për të marrë pjesë në sondazh, asistimin nga ana teknike të proçesit etj.
- Së fundmi, që prej muajit janar studentë të UV janë duke Vlerësuar mësimdhënien online, nëpërmjet Sondazhit për "Zhvillimin e mësimit online", të organizuar prej ASCAL, i cili është përsëri një instrument i vlerësimit të jashtëm.

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ vlerëson përpjekjet e insitucionit për pjesëmarrjen në sondazhe kombëtare si dhe në organizmin e sondazhit për "Zhvillimin e mësimit online", por insitucioni nuk paraqet vlerësimeve analitike e krahasuese.
Vlerësimit për Standardin V.5/2 Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë përdorimin e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional."
*GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

## ❖ STANDARDI VI.5

**Kriteri 2:** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.

***GVJ ndër të tjera komenton:*** "Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit.

**Në lidhje me çfarë është shprehur GVJ, DSBCP argumenton:** Referuar "Proçedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, miratuar me Vendim Senati nr.21 , datë 08.05.2018, pas përcjelljes së Raportit të Analizës së Pyetësorëve pranë çdo Njësie Kryesore më tej çdo njësie bazë, Raporti Publikohet edhe në faqen zyrtare të Internetit të Universitetit. Në referenca gjenden linket e raporteve , të cilat janë një dëshmi e

[10] Evidence: Studentë të Angazhuar në grupin e punës mbi sondazhin kombëtar të studentëve

drejtpërdrejtë e publikimit të raportit.[11] Me qëllim ruajtjen e privatësisë dhe lirisë akademike rezultatet për çdo probram studimi studimi, publikohen në nivel programi studimi në trajtën e mesatares aritmetike të përgjigjeve për çdo pyetje dhe çdo lëndë.

**Përgjigjja GVJ:**
GVJ pasi shqyrtoi dokumentet e publikuara në faqen zyrtare të UV të Proçedurës së Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të Studentëve për Cilësinë e Mësimdhënies për Lëndët e çdo Programi Studimi në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, konstatohet se instumentet e vlerësimit të ngritur si dhe analiza e të dhënave ka në fokus të studimit të saj performancën e lektorit dhe vlerësimin e programit të studimit.
Vlerësimi për Standardin VI.5/2 i qëndron vlerësimit: Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit. *GVJ i qëndron vlerësimit fillestar të standardit: përmbushet kryesisht.*

[11] https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-i-Shkencave-Humane-Raporti-i-Analizes-se-Pytesoreve-te-Studenteve-.pdf dhe https://univlora.edu.al/wp-content/uploads/2019/12/Fakulteti-i-Shkencave-Humane-Raporti-i-Analizes-se-Pytesoreve-te-Studenteve-.pdf

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Mësuesi në Arsimin Parashkollor"

## I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. | Në Statutin e UV[12] theksohet në nenin 3 se UV e zhvillon veprimtarinë e tij në drejtim të formimit të specialistëve të lartë dhe të shkencëtarëve të rinj në *përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit.* Gjithashtu, UV ka për qëllim zhvillimin e kulturës, arsimit dhe shkencës, *për ndërtimin dhe konsolidimin e shoqërisë demokratike dhe të shtetit ligjor.*<br>Në Planin Strategjik të UV për vitet 2018-2024[13] theksohet se UV synon të luajë një rol përcaktues dhe dominues në edukimin e vlerave qytetare dhe demokratike për integrimin e shoqërisë shqiptare në shoqërinë europiane.<br>Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" bazohet kryesisht në Ligjin nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, si edhe në dokumentet bazë rregullatore të institucionit që janë Statuti i UV, Plani Strategjik 2018-2024, si edhe në dokumentet e tjera të lidhur me ta. |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" në programin të tij[14], midis të tjerash parashikon edhe zhvillimin e lëndëve Gjuhë Shqipe, Edukatë Qytetare, si edhe Histori Kombëtare dhe Didaktike. E gjithë struktura e këtij programi studimi synon përgatitjen e mësuesve për arsimin parashkollor duke u bazuar në një traditë të hershme arsimore, si edhe duke e përshtatur këtë traditë me kërkesat e kohës dhe me detyrimet që ka marrë përsipër për të përmbushur Republika e Shqipërisë në kuadër të zhvillimeve integruese europiane. |

12 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

13 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca B, Plani Strategjik 2018- 2024", ASCAL, Dok. nr.50. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

14 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.4, Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)", ASCAL, Dok. nr.9. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Në nenin 3/1. a të Statutit të UV[15], theksohet se misioni i UV është *ofrimi i programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tre ciklet e studimit të arsimit të lartë, referuar niveleve 5, 6, 7, si edhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).* Gjithashtu, në nenin 3/2.a të Statutit, theksohet se UV e zhvillon veprimtarinë *në drejtim të mësimdhënies bashkëkohore*, sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare.<br>Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" i përgjigjet nivelit 6 të KSHK dhe synon[16] që të formojë *specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, si edhe të përgatisë specialistë të rinj në disiplina pedagogjike të disa niveleve në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.*<br>Ndërsa në Rregulloren e Programit të Studimit[17] theksohet se ky *program studimi është pjesë e programeve të ofruara nga Fakulteti i Edukimit.*<br>Konkludohet se Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe fushën e veprimtarisë të UV. |
| **Kriteri 4.** Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar. | Në Planin Strategjik 2018-2024[18] theksohet se UV synon:<br>- të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës dhe me gjerë;<br>- të ndihmojë në përmbushjen e nevojave sociale, kulturore dhe zhvillimore të vendit.<br>Gjithashtu, në këtë plan theksohet se:<br>- diplomimi, vlera e diplomës së fituar në tregun e punës dhe punësimi do të jenë sfida kryesore në 5 vitet e ardhshme.<br>- bashkëpunimi me biznesin nëpërmjet marrëveshjeve institucionale do të shërbejë si një mekanizëm efektiv për të identifikuar nevojat e tregut të punës për figura të caktuara profesionale.<br>Në Rregulloren e Programit të Studimit[19], theksohet se: *Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është hartuar në përputhje me nevojat e shkollës dhe të tregut të punës.* Konstatohet se Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", i bazuar në dokumentet kryesore rregullatore të UV, synon përgatitjen e specialistëve të lartë që të jenë të aftë të konkurrojnë si në tregun |

[15] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[16] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[17] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[18] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca B, Plani Strategjik 2018- 2024", ASCAL, Dok. nr.50. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[19] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | lokal të punës, ashtu edhe në atë kombëtar. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit. | Në Planin Strategjik[20] 2018-2024 të UV, theksohet se misioni i UV është i orientuar në këto drejtime:<br>- të kontribuojë në promovimin dhe përhapjen e njohurive shkencore tek studentët nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë të disiplinave të mësimdhënies dhe të kërkimit.<br>- të sigurojë një rol udhëheqës në ekonominë lokale si edhe në zhvillimin kulturor të qytetit të Vlorës.<br>Gjithashtu, vizioni i UV, i shprehur qartë në këtë plan strategjik, midis të tjerash, është që UV të jetë drejtues dhe orientues i zhvillimit në *mësimdhënie dhe ekselencë*, si edhe në *hulumtim dhe kërkim*.<br>Sipas Strategjisë për zhvillimin e DE për 2017-2022[21], theksohet se "*diplomat Bachelor synojnë të sjellin përkatësisht një sistem të ekuilibruar e të strukturuar konceptesh mbi kategoritë themelore disiplinare mbi edukimin për rrafshet moshore parashkollore…*".<br>Konstatohet se Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është në përshtatje me strategjinë e zhvillimit të institucionit, si edhe i bazuar në misionin dhe synimet që UV i ka të përcaktuara në Statutin dhe Planin Strategjik të tij. |
| **Kriteri 2.** Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen | Në Statutin e UV[22], në nenin 6/3 theksohet se: "*UV, në përputhje me objektivat e tij të politikës arsimore, të kërkimit shkencor, të mësimdhënies, harton programe dhe projekte specifike sipas nevojave të fushave të ndryshme*".<br>Në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane[23], në përbërje të të cilit është edhe Departamenti i Edukimit që mbulon |

[20] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca B, Plani Strategjik 2018- 2024", ASCAL, Dok. nr.50. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[21] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[22] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[23] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH", ASCAL, Dok. nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit. | Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", në nenin 3 tregohet se: "*FSHH ka si qëllim bazë mësimdhënien, punën kërkimore-shkencore..., si edhe ofron programe rigoroze studimi, ... si edhe metoda bashkëkohore të mësimdhënies*". Theksohet, gjithashtu, se specifikat e kërkimit shkencor zgjidhen të tilla që të jenë në përputhje me zhvillimet humane, sociale dhe ato të edukimit.<br>Konstatohet se statuti dhe rregullorja e FSHH përcaktojnë si një nga drejtimet prioritare mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushën e edukimit dhe se Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është ndërtuar në harmoni me këto drejtime prioritare. |
| **Kriteri 3.** Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit. | Siç është përmendur në kriteret 1 dhe 2 të Standardit I.2, një nga drejtimet kryesore akademike të UV është ofrimi i programeve "Bachelor" në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit me specifikë në rrafshin parashkollor. Në këtë kënvështrim, emërtimi i Programit të studimit si *"Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"* është në përputhje të plotë me një nga drejtimet kryesore akademike të institucionit.<br>Organizimi, struktura, si edhe përmbajtja e këtij programi plotëson kërkesat e VKM nr.41, datë 24.1.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Gjithashtu, në dokumentet rregullatore të UV, si Statuti, Rregullorja e UV, apo përmes veprimtarisë së Senatit Akademik, përcaktohet edhe rrugëtimi që duhet të ndiqet deri në miratimin përfundimtar të një programi studimi. Kështu, fillimisht vjen propozimi i departamentit, më pas miratimi paraprak nga Këshilli i Fakultetit, vijon me miratimin e Dekanit dhe më pas me miratimin e Senatit Akademik.<br>Konstatohet se Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", pas përfundimit me sukses të tij, i mundëson studentëve pajisjen me diplomë universitare në një fushë që është e parashikuar në drejtimet kryesore akademike të UV, ndërsa organizimi dhe struktura e tij i nënshtrohen rregullores përkatëse të këtij programi, që edhe vetë kjo rregullore është e bazuar në dokumentet kryesore rregullatore të UV. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit. | Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[24] mungojnë objektivat për formimin e studentëve. Gjithashtu, nuk tregohen dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.<br>***Rekomandohet*** *që të bëhet plotësimi i Rregullores së Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ku në të të parashikohen:*<br>- *objektivat e programit të studimit;*<br>- *dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që fitohen nga studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. | Institucioni nuk ka patur detyrim ligjor që të bënte studime paraprake lidhur me studimin e tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës, përpara hapjes së Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", pasi ky program është hapur për herë të parë në vitin 2002 dhe në këtë kohë ky element nuk ka qënë detyrim ligjor.<br>Në RVB nuk ka referenca për komunikim zyrtar me punëdhënësit e fushës lidhur me nevojat dhe kërkesat e tyre për specialistë të arsimit parashkollor.<br>Institucioni ka gjurmuar dhe ka të dhëna për punësimin e studentëve të diplomuar pranë UV ndër vite. Këto të dhëna gjenden në Raportet vjetore të UV për vitet 2017-2018 dhe 2018-2019[25]. |
| **Kriteri 3.** Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. | Siç u theksua edhe në vlerësimin e Kriterit 1 të Standardit I.3, në Rregulloren e Programit të Studimit nuk tregohen rezultatet e të nxënit, si edhe shkathtësitë dhe kompetencat që duhet të arrijnë studentët. Shihet qartë që rregullorja e programit të studimit merret kryesisht me mënyrën e funksionimit dhe të organizimit të programit të studimit.<br>***Rekomandohet*** *rishikimi i rregullores së programit të studimit në përputhje me kriteret 1 dhe 3 të Standardit I.3.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

24 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
25 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca I, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2017- 2018", ASCAL, Dok. nr.57. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Standardi I.4<br>**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zbatohet nga një staf kryesor akademik dhe staf ndihmës, i cili është një kombinim brezash, kulturash, si edhe përvojash të shumëllojta. Në staf ka pedagogë me përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies. Gjithashtu, stafi akademik ka në jetëshkrimin e tij specializime të shumta dhe të shumëllojshme si edhe mbart mbi vehte një përvojë të pasur shumëvjeçare. Si rrjedhojë, burimet njerëzore dhe infrastrukturore janë të mjaftueshme për zhvillimin në normalitet të procesit mësimor si edhe ka një qëndrueshmëri të kuadrit akademik, si edhe një raport të përshtatshëm midis brezave të ndryshëm të personelit akademik. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Siç është treguar edhe në kriterin 3 të Standardit I.1, në nenin 3/1.a të Statutit të UV[26], theksohet se misioni i UV është *ofrimi i programeve të studimit në fusha të ndryshme në të tre ciklet e studimit të arsimit të lartë, referuar niveleve 5, 6, 7, si edhe 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK)*. Gjithashtu, në nenin 3/2.a të Statutit, UV e zhvillon veprimtarinë *në drejtim të mësimdhënies bashkëkohore*, sipas të gjitha standarteve ndërkombëtare. Pra fusha e përgjithshme e programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është në harmoni me fushën akademike kryesore të UV dhe të FSHH.<br>Gjithashtu, në Rregulloren e Programit të Studimit [27] theksohet se ky *program studimi është pjesë e programeve të ofruara nga Fakulteti i Edukimit.*<br>Konkludohet se Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe fushën e veprimtarisë të UV-FSHH, si edhe programi është në harmoni me direktivat kombëtare që rregullojnë veprimtarinë e IAL-ve. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të | Departamenti i Edukimit është hartuesi dhe zbatuesi i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin |

26 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
27 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Parashkollor". Ky program i përgjigjet nivelit 6 të KSHK dhe synon[28] që të formojë *specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, si edhe të përgatisë specialistë të rinj në disiplina pedagogjike të disa niveleve në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.*<br>Nga vizita on-line në institucion, si edhe nga konsultimi me dokumentet e paraqitura, rezulton se në UV nuk zhvillohen programe ndërdisiplinore. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Rregullimi i jetës së brendshme si edhe veprimtaria e UV rregullohet kryesisht përmes Statutit[29] dhe Rregullores së UV[30].<br>Në Statut (neni 6, pika 5), theksohet se *veprimtaria e UV organizohet dhe realizohet nëpërmjet njësive përbërëse akademike, ndihmësakademike dhe administrative të shtrira në njësitë kryesore dhe në strukturën e rektoratit. Veprimtaria e UV-së drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në ligjin e arsimit të lartë, në statut, në rregullore, dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.*<br>Rregulla më të hollësishme të rregullimit të jetës së brendshme të UV përcaktohen në Rregulloren e UV. Sipas kësaj rregulloreje:<br>- Njësitë kryesore kanë rregullore të brendshme, që hartohen nga këshillat përkatëse dhe miratohen nga Senati Akademik. (neni 3)<br>- UV vepron në bazë të vendimeve, urdhërave dhe udhëzimeve. (neni 6)<br>- Në nenin 13 jepet gjithë hierarkia e organizimit të UV, nga Rektori, deri tek personeli akademik.<br>Në bazë të Rregullores së UV, funksionojnë sipas hierarkisë:<br>- Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane[31] |

[28] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[29] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A. Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[30] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | –Rregullore e Departamentit të Edukimit32<br>–Rregullore e Programit të Studimit “Bachelor” në “Mësuesi për Arsimin Parashkollor”33<br>Rezulton se UV e ushtron veprimtarinë e vet përmes rregulloreve dhe strukturave që mundësojnë zhvillimin normal të veprimtarisë së tij dhe pavarësinë e degëve të tij, por edhe kontrollin dhe ekuilibrin e këtyre strukturave. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj. | Universiteti i Vlorës ka miratuar strategjinë e ndërkombëtarizimit për vitin 2016-202034. Në faqen zyrtare të UV, si edhe në dokumentat e paraqitura për akreditim, rezulton se disa nga marrëveshjet e arritura me institucione të huaja kanë në objekt fushën e edukimit35. Më poshtë tregohen disa nga këto marrëveshje bashkëpunimi me fokus edukimin:<br>– Marrëveshje me Universitetin e Atikës Perëndimore (Greqi), me periudhë vlefshmërie 2020-2027, ku parashikohen shkëmbime studentësh dhe personeli akademik;<br>– Marrëveshje me Universitetin e Edukimit-Vjenë Austri, me periudhë vlefshmërie 2016-2021, ku parashikohen shkëmbime studentësh dhe personeli akademik në trajnim-mësuesi dhe në fushën e edukimit;<br>– Marrëveshje me Universitetin e Pitestit-Rumani, me periudhë vlefshmërie 2018-2021, ku parashikohen shkëmbime personeli akademik dhe personeli administrativ në shkencat e edukimit;<br>– Marrëveshje me Universitetin e Anadolur-Turqi, me periudhë vlefshmërie 2018-2021, ku parashikohen shkëmbime studentësh, personeli akademik, si edhe personel administrativ në fushën e mësimdhënies së gjuhës Angleze;<br>– Marrëveshje me Universitetin Jan Kocanovski Poloni, me periudhë vlefshmërie 2018-2021, ku parashikohen shkëmbime studentësh, personeli akademik, si edhe personel administrativ në fushën e Edukimit;<br>Në Raportin Vjetor 2018-2019, në faqen 21-23, jepen memorandumet e mirëkuptimit (MoU) që ka lidhur UV me universitete të huaja së bashku me përfitimet e dyanshme. Gjithashtu, në faqen 23 të atij raporti jepen edhe lista e rrjeteve universitare ku bën pjesë UV.<br>UV ka të miratuar gjithashtu edhe Rregulloren për implementimin |

31 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, FSHH, DE, “Evidenca 1.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH”, ASCAL, Dok. nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

32 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, FSHH, DE, “Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE”, ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

33 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, FSHH, DE, “Plani Mësimor i Programit të Studimit”, ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

34 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, FSHH, DE, “Evidenca D, Strategjia e Ndërkombëtarizimit”, ASCAL, Dok. nr.52. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

35 Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, FSHH, DE, “Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019”, ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | e marrëveshjeve ndërinstitucionale në kuadër të programit Erasmus+ KA107 International Credit Mobility36, ku përshkruhen hapat që ndiqen nga aplikimi deri në fitimin e mobiliteteve të fituara.<br>Në kuadër të bashkëpunimit të brendshëm, UV ka nënshkruar edhe marrëveshjen për bashkërendimin e praktikave mësimore dhe të veprimtarive mësimore (Janar 2018) me Drejtorinë Arsimore Rajonale-Vlorë37 sipas të cilës përcaktohen veprimtaritë në të cilat do të angazhohen të dy institucionet, si edhe detyrimet e dyanshme të secilit institucion. |
| **Kriteri 3.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve. | Njësia përgjegjëse për Programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është Departamenti i Edukimit (DE). Në Rregulloren e UV38, në nenin 25 të saj theksohet se:<br>- Përgjegjësi i departamentit ndjek dhe kontrollon aktivitetin shkencor në department dhe mban dokumentacionin e aktivitetit shkencor dhe akademik;<br>- Organizon analizën vjetore të punës mësimore shkencore dhe analiza periodike;<br>Nga konsultimi me dokumentacionin e depozituar, rezulton se në RVB mungojnë raportet analitike vjetore të DE. Kështu që nuk mund të konkludohet nëse në këto raporte janë përfshirë përfitimet e arritura nga marrëveshjet e bashkëpunimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë. | UV ka nënshkruar edhe marrëveshjen për bashkërendimin e praktikave mësimore e të veprimtarive mësimore (Janar 2018) me Drejtorinë Arsimore Rajonale-Vlorë39 sipas të cilës përcaktohen veprimtaritë në të cilat do të angazhohen të dy institucionet, si edhe detyrimet e dyanshme të secilit institucion.<br>Sipas kësaj marrëveshje bashkëpunimi, veprimtaritë që do të përfshijnë të dy institucionet janë:<br>- Praktikat mësimore profesionale;<br>- Punimet e diplomave për MP;<br>- Projekte zhvillimi, kërkimore-shkencore ose dypalëshe.<br>Gjithashtu, në evidencën 4.5, tregohet edhe korrespodenca që UV ka mbajtur me Drejtoritë Arsimore Rajonale Fier, Lushnjë, Berat, Ballsh, lidhur me praktikat mësimore që duhet të ndjekin studentët e programit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" pranë institucioneve parashkollore të këtyre rajoneve. |

36 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca H, Rregullore për Implementimin e ICM-ve", ASCAL, Dok. nr.56. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

37 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.5,", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

38 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

39 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.5,", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Në Statutin e UV[40], në nenin 3 të tij, theksohet se UV ka si mission ofrimin e programeve të studimit në të tre ciklet e studimit të arsimit të lartë…referuar niveleve 5, 6 , 7, 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Sipas kësaj kornize, në nivelin 5 (pika 3 *Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës*) përfshihen:<br>– Kurse kalimi (çertifikatë)<br>– Kurse specializimi bazuar në kërkesa profesionale<br>Ndërsa në RVB e paraqitur nga UV, theksohet se DE është në proces studimi tregu për ofrimin e programeve të studimit të formimit të vazhduar, si formë e të mësuarit gjatë gjithë jetës.<br>Rezulton se nuk ka zbatime në praktikë për ofrimin e këtyre kurseve të kalimit apo të specializimit që lidhen me kualifikime për të nxënit gjatë gjithë jetës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[41] është i organizuar me 180 kredite (ECTS) dhe me kohëzgjatje 3 vjet, ku çdo vit akademik ka 60 kredite. Programi i studimit është i organizuar me lëndë dhe module[42], ku për çdo lëndë apo modul specifikohen kreditet që merren pas kalimit me sukses të lëndës apo modulit.<br>Programi i studimit i referohet nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është në përputhje me nenet 69-73 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në |

40 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

41 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

42 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| (ECTS). | institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". |
| **Kriteri 2.** Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh. | Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" i përgjigjet nivelit 6 të KSHK dhe synon[43] që të formojë specialistë të lartë kryesisht në mësimdhënie, si edhe të përgatisë specialistë të rinj në disiplina pedagogjike të disa niveleve në përshtatje me tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.<br>Shprehitë e veçanta në fushën e arsimit parashkollor formohen përmes zhvillimit të lëndëve karakterizuese si Gjuhë Shqipe, Matematikë, Edukim Muzikor dhe Edukim Artistik etj.[44]<br>Por, nga shqyrtimi i planit mësimor që strukturon Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" u konstatua se mungojnë disiplinat të cilat i pajisin studentët me dije dhe kompetenca nga fusha e Shkencave të Natyrës.<br>***Rekomandohet*** *që të rishikohet plan mësimor i këtij programi studimi, me qëllim integrimin edhe të lëndës "Njohuri bazë për Shkencat e Natyrës". Për një realizim sa më të plotë të rezultatete të të nxënit të kësaj lënde të parashikohen dhe orët laboratorike, dhe ato të kenë një peshë të përcaktuar qartë në përmbajtjen e programit të lëndës.* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës. | Në strategjinë e zhvillimit të DE[45] theksohet se Diplomat Bachelor synojnë:<br>– *të sjellin një sistem të ekuilibruar dhe të strukturuar konceptesh mbi kategoritë themelore disiplinare mbi edukimin për rrafshet moshore parashkollore;*<br>– *të mbështesin kahjen pedagogjike si drejtim i veçantë;*<br>Në nenin 14 të Rregullores së DE[46] theksohet se*: Mësimdhënia në DE është e organizuar në dy pjesë,* ***në pjesën teorike*** *dhe në pjesën praktike, të cilat ecin në marrëdhënie komplementare me njëra-tjetrën. Synimi është që studenti jo vetëm të aftësohet që të përdorë njohuritë teorike në fushat përkatëse, por, mbi të gjitha, të formohet nga pikpamja shkencore.*<br>Njohuritë e përparuara, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së arsimit parashkollor formohen përmes zhvillimit të lëndëve të ndryshme të përcaktuara në planin mësimor të këtij programi studimi.[47] |

43 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

44 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Dokumentet shtesë, evidenca 3, Programi mësimor i Programit të studimit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

45 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

46 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

47 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Dokumentet shtesë, evidenca 3, Programi mësimor i Programit të studimit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Në strategjinë e zhvillimit të DE[48] theksohet se Diplomat Bachelor synojnë:<br>– të inicojnë formimin e profesionistëve të sigurt, të aftë që të përdorin në praktikë kategoritë nocionore dhe metodologjike të përfituara në studim, të përgatisin themelet për studimin e thelluar në të ardhmen në disiplina me kahje të ngjashme profesionale.<br>Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e avancuara në fushën e arsimit parashkollor, formohen përmes zhvillimit të lëndëve si Komunikimi, Tipet e Handikapit, Psikologji Loje etj[49]. |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore. | Rregullorja e Programi i studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" pasqyron ndryshimet dhe kërkesat ligjore të rrjedhura nga zbatimi i Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si edhe i Ligjit nr.10171 datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, programi i studimit përfshin në përgjithësi shumicën e elementeve që parashikon si të detyrueshme VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", e ndryshuar. Shumica e këtyre elementëve të detyrueshëm pasqyrohen në Rregulloren e Programit të studimit[50], në të cilin pasqyrohen:<br>–kreditet, sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);<br>–mënyra e kontrollit të dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;<br>–plani mësimor;<br>–kuotat e pranimit dhe grupet mësimore; programi lëndor (Syllabus-et);<br>–profili i programit; diploma dhe suplementi.<br>Në Rregulloren e Programit të Studimit nuk përfshihen katër elementët e mëposhtëm që janë të detyrueshëm sipas VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar me VKM Nr. 879, datë 18.12.2019:<br>–rezultatet e të nxënit dhe kompetencat profesionale;<br>–veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit |

48 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

49 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Dokumentet shtesë, evidenca 3, Programi mësimor i Programit të studimit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

50 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | të studimit;<br>- kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë këtë program studimi;<br>- kodi i Etikës.<br>***Rekomandohet*** *që Rregullorja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" të plotësohet në përputhje me të gjitha kërkesat që VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", të ndryshuar[51], i konsideron si të detyrueshme. Kryesisht rregullorja të plotësohet me katër elementët e detyrueshëm të përmendur më sipër në këtë pikë.* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi akademik i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" për vitin 2019-2020[52], siguron ndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë (32 kredite, ose 17.8%), lëndë karakterizuese (91 kredite, ose 50.5%), lëndë ndërdisiplinore (29 kredite, ose 16.1%), lëndë plotësuese (22 kredite, ose 12.2%), si edhe detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.3%), duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore si edhe kreditet përkatëse për çdo lëndë. Kjo shpërndarje është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë".<br>Programet specifike të çdo lënde[53] janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", duke përfshirë:<br>- Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut;<br>- Përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit;<br>- Konceptet themelore, temat e lëndës;<br>- Forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi;<br>- Kontrolli i vazhdueshëm, literatura;<br>- Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| |
|---|
| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për** |

51 Ndryshuar me VKM nr.879, datë 18.12.2019

52 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

53 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1, Syllabuset e lëndëve", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| këto njësi. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. | Referuar Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", kërkesë kryesore për hapjen e një programi studimi është që *Njësia bazë duhet të ketë në përbërje të saj, të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë, si personel akademik, ndër të cilët, të paktën tre, duhet të jenë me gradë shkencore ose titull akademik.* Departamenti i Edukimit në FSHH ka në përbërje të tij sot 14 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 13 janë me tituj/grada shkencore54. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse. | Pozicioni i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët është përcaktuar në nenin 77 të Statutit të UV[55], sipas të cilit *Koordinatori për marrëdhëniet me studentët është anëtar i stafit akademik të njësisë bazë*, i emërtuar nga drejtuesi i njësisë bazë, për të koordinuar marrëdhëniet e departamentit me studentët. Koordinatori kryen promovimin e programeve të studimit të ofruara nga njësia bazë. Ai informon dhe këshillon studentët për veprimtaritë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Koordinatori këshillon studentët për problematika të ndryshme dhe raporton problematikat në department.<br>Rezulton se DE e ka përmbushur këtë detyrim të statutit dhe ka caktuar Koordinatorin për studentët 56. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | UV, sa i përket strukturës dhe organizimit akademik, është në harmoni me kërkesat e neneve 22, 23, si edhe 25 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, organizimi i UV është bazuar edhe në Statutin e UV[57], në nenet 8, 9, 10, si edhe 13 të tij. Kështu, UV është i organizuar në njësi njësi kryesore (për programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" njësia kryesore është Fakulteti i Shkencave Humane), si edhe në njësi bazë (në rastin tonë njësia bazë është Departamenti i Edukimit). Në përbërjen e DE janë aktualisht 14 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 13 |

54 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabela nr.6.4. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

55 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

56 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.5, Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët", ASCAL, Dok. nr.15. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

57 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | janë me tituj/grada shkencore. Gjithashtu, në strukturën e DE ekziston edhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, në të cilën bën pjesë sekretaria mësimore, e cila mirëmban dhe administron gjithë dokumentacionin e duhur arsimor. Rezulton se raporti PAE/PAK për vitet 2016-2020 ka qënë dukshëm shumë më lart nga kufiri ligjor që është 70% [58]. |
| **Kriteri 4.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. | Për programin e studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" janë të angazhuar **për vitin akademik 2019 -2020**, 14 personel akademik efektiv PAE me kohë të plotë të ndarë si më poshtë:<br>– 1 personel me titull Profesor i Asociuar<br>– 12 personel mban gradën Dr/PhD<br>– 1 personel është Master i Shkencave (në proces doktorature)<br>Ndërsa personel akademik me kontratë PAK, janë gjithsej 2 personel me gradën MSc, nga të cilët 1 personel është në proces doktorature.<br>Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK për vitin akademik 2019-2020, për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", thekson **mbulimin në masën 87% me personel akademik efektiv kundrejt 13% me personel akademik me kontratë.**<br>**Për vitin akademik 2018-2019**, kanë qënë angazhuar 18 personel akademik efektiv PAE me kohë të plotë të ndarë si më poshtë:<br>– 1 personel me titull Profesor i Asociuar<br>– 13 personel me gradën Dr/PhD<br>– 4 personel me Master i Shkencave (në proces doktorature)[59]<br>Ndërsa personel akademik me kontratë PAK, kanë qënë gjithsej 3 personel me gradën MSc, nga të cilët një në process doktorature.<br>Raporti që del nga të dhënat e dokumentacionit për PAE/PAK për vitin akademik 2018 -2019, për programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", thekson **mbulimin në masën 86% me personel akademik efektiv kundrejt 14% me personel akademik me kontratë.**<br>Gjithashtu, rezulton se në periudhën 2016-2020, raporti PAE/PAK ka qënë dukshëm shumë më lart nga kufiri ligjor që është 70%[60].<br>Rezulton se DE i përmbush detyrimet ligjore sa i përket numrit dhe shkallës së kualifikimit të personelit akademik, në respekt të kërkesave të Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë |

58 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Tabela nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

59 Ibid

60 Ibid

| | |
|---|---|
| | dhe të degëve të tyre". |
| **Kriteri 5.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike. | Si rezulton dhe nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, në përbërjen e Departamentit të Edukimit janë aktualisht 14 pedagogë me kohë të plotë, nga të cilët 13 janë me tituj/grada shkencore. Gjithashtu, në strukturën e DE ekziston edhe personeli ndihmës akademik me karakter administrativ, në të cilën bën pjesë sekretaria mësimore, e cila mirëmban dhe administron gjithë dokumentacionin e duhur arsimor. Siç është përmendur edhe më sipër në këtë RVJ, raporti PAE/PAK për vitet 2016-2020 ka qënë dukshëm shumë më lart nga kufiri ligjor që është 70%[61]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuara dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Rregullorja e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[62], përcakton:<br>– në nenin 1, organizimin në kohë dhe në kredite të Programit të Studimit;<br>– në nenin 4-6, mënyrën e pranimit dhe të regjistrimit të kandidatëve;<br>– në nenin 9-10, mënyrën e organizimit në vite, semestre, lëndë, si edhe praktika profesionale;<br>– në nenin 14, kontrollin e dijes;<br>– në nenin 17, frekuentimin;<br>– në nenin 18, detyrimin për kryerjen e praktikës profesionale;<br>– në nenin 19, dhënien e provimit të formimit apo përgatitjen e temës së diplomës;<br>– në nenin 21, pajisjen me diplomë "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".<br>Këto të dhëna studenti mund t'i gjejë në mënyrë individuale edhe në faqen zyrtare elektronike të UV (https://univlora.edu.al). |
| **Kriteri 2.** Programet e studimit organizohen në lëndë, module, | Plani Mësimor i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[63] është ndërtuar në përputhje me |

[61] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Tabela nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[62] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[63] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. | përcaktimet e VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"[64] dhe përcakton lëndët/modulet, praktikat dhe aktivitetet formuese, të ndara në vite akademike dhe semestra. Për çdo lëndë/modul përcaktohen viti/semestri kur zhvillohet, orët në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimet e shlyerjes, si edhe kreditet e përcaktuara sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra. | Plani Mësimor i Programit të Studimit[65] është ndërtuar në përputhje me përcaktimet e VKM nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"[66] dhe përcakton lëndët/modulet e ndara në vite akademike dhe semestra. Për çdo lëndë/modul përcaktohen viti/semestri kur zhvillohet, orët në auditor, orët jashtë auditorit, detyrimet e shlyerjes, si edhe kreditet sipas sistemit ECTS. Siç është përmendur edhe më përpara në këtë RVJ, për këtë program studimi, aktivitetet formuese ndahen si vijon:<br>– Lëndë bazë (32 kredite, ose 17.8%), gjithsej 4 lëndë;<br>– Lëndë karakterizuese (91 kredite, ose 50.5%), gjithsej 12 lëndë;<br>– Lëndë ndërdisiplinore (29 kredite, ose 16.1%), gjithsej 4 lëndë;<br>– Lëndë plotësuese (22 kredite, ose 12.2%), gjithsej 5 lëndë;<br>– Detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.3%).<br>– Gjithsej 180 kredite ECTS.<br>Kjo shpërndarje është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". |
| **Kriteri 4.** Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" përmban edhe Planin Mësimor[67] të Programit të Studimit. Plani mësimor përmban kodin e lëndës, emrin e lëndës, kreditet, ngarkesën mësimore në orë brënda dhe jashtë auditorit.<br>Ndarja e orëve mësimore në auditore në orë për leksione, orë për seminare, orë për ushtrime për çdo disiplinë, përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit, bazuar në numrin e krediteve të çdo disipline. Çdo krediti i korrespondojnë 25 orë mësimore punë të studentit. Gjatë një viti mësimor, sasia e krediteve të përfituara është 60.<br>Theksojmë se orët maksimale për të tre vitet e studimit janë |

64 VKM Nr.41, datë 24.01.2018, *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"*

65 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Tabela Nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

66 VKM Nr.41, datë 24.01.2018, *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"*

67 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | 4500, nga të cilat 1919 janë orë brenda auditorit, ndërsa 2581 orë janë të përcaktuara si orë jashtë auditorit. Rezulton se raporti orë jashtë auditorit kundrejt orëve të përgjithshme është 57%. Ky raport rezulton se është në harmoni me kërkesat e pikës 2.1/ç të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë"68 |
| **Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Në UV, procesi i pranimit të studentëve të vitit të parë të Programit të Studimeve "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" bazohet së pari në nenin 74 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nisur nga kriteri i notës mesatare të përcaktuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, në nenin 5 të Rregullores së Programit të Studimit69 theksohet se pranimi i kandidatëve të rinj (numri i kuotave) bëhet sipas listave përkatëse të miratuara nga MASR.<br>Bazuar në procedurat e kërkuara nga Ligji nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet ligjore në zbatim të tij, njësia kryesore (FSHH) i përcjell çdo vit Rektoratit kriteret e pranimit në programin e studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"70, ndërsa njësia bazë (DE) për çdo vit akademik i përcjell njësisë kryesore (FSHH) kuotat e pranimit për studentët e vitit të parë të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"71. |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programet specifike të çdo lënde72 janë bazuar dhe plotësojnë kërkesat e Shtojcës nr.2 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë" dhe përfshijnë:<br>– Pjesën përshkruese, tipin e lëndës, llojin e lëndës, kreditet, kodin, si edhe adresën elektronike të pedagogut;<br>– Përmbledhjen dhe rezultatin e të nxënit;<br>– Konceptet themelore, temat e lëndës;<br>– Forma e kontrollit të dijeve, frekuentimi;<br>– Kontrolli i vazhdueshëm, literatura;<br>– Vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në | Nga bisedat me pedagogët e DE që mbulojnë Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", u |

68 VKM Nr.41, datë 24.01.2018, *"Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL"*

69 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.7 (shtojcë). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
70 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.7, Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit të Ciklit të Parë në DE", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
71 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
72 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1, Syllabuset e lëndëve", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | pohua prej tyre se planet mësimore rishikohen çdo vit me qëllim përditësimin e tyre. Rezulton, gjithashtu, se Plani akademik mësimor më i fundit i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" është i miratuar në vitin 2019 dhe i përket vitit mësimor 2019-2020. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. | Plani mësimor i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" në UV është organizuar:<br>– sipas përcaktimeve të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë";<br>– sipas Rregullores së Programit të Studimit73;<br>– sipas Kalendarit Akademik të UV74.<br>Kurrikula është shpërndarë për 3 vite akademike me nga 60 ECTS secili dhe për secilin vit akademik janë përcaktuar jo më pak se 1.500 orë. Siç është parashikuar në ligj, fillimi dhe përfundimi i vitit akademik përcaktohet me vendim të MASR. Sipas RVB75 rezulton se çdo semestër zgjat 15 javë, ndërsa ngarkesa javore është deri 25 orë mësimore me kohëzgjatje 50 minuta. |
| **Kriteri 2.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve. | Edhe shpërndarja e orëve mësimore është realizuar sipas përcaktimeve të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Raporti i orëve leksion/seminare, bazohet në natyrën e lëndës (nëse lëndët janë me natyrë teorike apo praktike). Sa i përket zhvillimit të lëndëve me zgjedhje, ato koordinohen në varësi të numrit të studentëve që i ndjekin. |
| **Kriteri 3.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e | Plani mësimor i programit të studimit për vitin 2019-202076, siguron ndarje të lëndëve mësimore në lëndë bazë (32 kredite, ose 17.8%), lëndë karakterizuese (91 kredite, ose 50.5%), lëndë ndërdisiplinore (29 kredite, ose 16.1%), lëndë plotësuese (22 |

73 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
74 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.10, Kalendari akademik i Universitetit 2019-2020", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
75 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
76 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. | kredite, ose 12.2%), si edhe detyrime përmbyllëse (6 kredite, ose 3.3%), duke përcaktuar me detaje fushat disiplinore si edhe kreditet përkatëse për çdo lëndë. Kjo shpërndarje është në harmoni me kërkesat e Shtojcës 1 të VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". |
| **Kriteri 4.** Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, rezulton se struktura e programit, organizimi i lëndëve, ngarkesa në kredite, dhe raporti teori/praktikë është në përputhje me bazën ligjore në fuqi, që është VKM nr.41 datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", Shtojca nr.1, Tabela nr.1. |
| **Kriteri 5.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Mënyra e shpërndarjes së lëndëve në kurrikul synon lehtësimin e arritjeve të rezultateve të të nxënit të programit të studimit. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, ky program studimi është i organizuar në lëndë, module, praktika e aktivitete formuese, duke bërë të mundur arritjen e rezultateve të të nxënit, transferim të studimeve, të dhëna që janë të detajuara në kurrikulën dhe në Rregulloren e programit të studimit[77]. |
| **Kriteri 6.** Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. | Nga dokumentacioni i dorëzuar nga Institucioni, konstatohet që ka një mungesë të pjesshme të përditësimit të programeve lëndëve/moduleve me literaturë të detyruar dhe ndihmëse të përditësuar të 5 viteve të fundit.<br>***Rokomandohet*** *përditësimi i literaturës së detyruar, i programeve të lëndëve/moduleve të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", me literaturë të 5 viteve të fundit.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. | Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[78] nuk tregohen objektivat lidhur me formimin e studentëve. Gjithashtu, në rregullore nuk tregohen dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.<br>***Rekomandohet*** *që të bëhet plotësimi i Rregullores së Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ku në të të parashikohen:*<br>*– objektivat e programit të studimit;*<br>*– dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që fitohen nga studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.* |

[77] ibid
[78] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Programi i Studimit "Bachelor" në "Mësuesi në Arsimin Parashkollor" në Rregulloren e tij79 tregon se përfundimi i këtij programi mundëson punësimin drejt profesionit të mësuesisë në arsimin parashkollor. |
| **Kriteri 9.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës. | Siç edhe përcaktohet në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të dorëzuar nga Insitucioni, NJSBCVI në bashkëpunim me Departamentin e Edukimit dhe me Drejtorinë e Komunikimit dhe të Burimeve Njerëzore, organizon workshop-e dhe veprimtari, të cilat lidhen me mundësitë që kanë studentët për t'u përshtatur me tregun e punës.80 |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.5**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi. | Departamenti i Edukimit (njësia bazë) mbulon Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" dhe në të sot janë angazhuar 14 pedagogë me kohë të plotë, si edhe 2 pedagogë të tjerë me kohë të pjesshme81. Shpërndarja e gradave dhe e titujve akademikë është e mjaftueshme për përmbylljen me sukses të programit dhe është në harmoni me kërkesat e Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", sa i përket numrit minimal të personelit akademik të kërkuar si edhe gradave apo titujve akademikë të kërkuar (pika 2/xii e vendimit të përmendur më sipër). |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik | Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme që |

79 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

80 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, fq.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

81 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabela 1.4, fq.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit. | angazhohen për realizimin e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" kanë nivelin e kërkuar të kualifikimit në harmoni me kërkesat e Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Tabela 2.4 e Aneksit të RVB përcakton raportin e gradës/titullit të çdo personeli akademik kundrejt funksionit që ata mbajnë Profesor/Lektor/Asistent Lektor. Rezulton se ky raport është në harmoni me nenet 3, 4, si edhe 5 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Gjithashtu, personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ka së paku, kualifikimin e ciklit pasardhës. |
| **Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij. | Siç u përmend edhe më sipër në kriterin 2 të Standardit II.5, personeli akademik me kohë të plotë ka nivel arsimimi dhe kualifikimi të mjaftueshëm dhe të përshtatshëm për nivelin e këtij programi. Nisur nga jetëshkrimet e personelit akademik, rezulton se formimi i tyre bazë universitar, arsimimi i mëtejshëm plotësues, kualifikimet e mëtejshme të tyre, si edhe trajnimet e vazhdueshme të tyre, janë në përputhje me llojin dhe nivelin e programit të studimit[82]. Në veçanti, rezulton, gjithashtu, se çdo personel akademik mbulon ato lëndë/module që janë në përputhje me kualifikimin vetjak. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të | Praktika profesionale gjatë zhvillimit të Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zhvillohet në Semestrin e dytë të vitit të tretë[83]. Gjithashtu, menjëherë pas saj parashikohet edhe punimi i temës së diplomës. Sipas Rregullores së Programit të Studimit[84], të drejtën për punuar temën e diplomës e kanë vetëm studentët me notë mesatare mbi 9.0.<br>UV ka marrëveshje bashkëpunimi, për zhvillimin e praktikave profesionale për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", me Drejtoritë Rajonale Arsimore Vlorë, Lushnjë, Fier, Ballsh, Kuçovë[85]. Personeli akademik i ngarkuar për ndjekjen e praktikës profesionale është me gradën Doktor dhe është PAE[86]. |

82 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.11, CV e stafit akademik dhe ndihmës për Programin e Studimit Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.21. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

83 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

84 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

85 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabela 5. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

86 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabela 12.4. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| studimit. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Nga shqyrtimi i syllabuseve të lëndëve që zhvillohen në Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", u konstatua se nuk janë të planifikuara orët e laboratorë. Kjo dhe si rezultat, pasi në planin mësimor të këtij programi studimi, nuk është parashikuar zhvillimi i lëndëve nga fusha "Shkencat e Natyrës87. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve. | UV ka miratuar gjatë vitit 2020 *Udhëzues mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimit*88. Në këtë udhëzues, midis të tjerash përfshihen:<br>– objektivat kryesore dhe specifike;<br>– standardet, rregullat dhe proceset;<br>– modele të mësimdhënies;<br>– modele të mësimdhënies inovative;<br>– mësime demonstrimi në programe të mësuesisë;<br>– metodat e vendimmarrjes;<br>– vlerësimi i të nxënit të studentit;<br>– vlerësimi i mësimdhënies së lektorit;<br>– modele didaktike dhe pedagogjike. |
| **Kriteri 2.** Strukturat | Në nenin 3 të Ligjit nr.80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin |

87 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabela 13. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

88 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" theksohet se: *Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Struktura dhe funksionimi i njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë përcaktohen në statutin e institucionit të arsimit të lartë.*<br>Statuti i UV[89], në nenet 80-82 të tij, përcakton mënyrën se si do të kryhet sigurimi i brendshëm i cilësisë, strukturat që do ta kryejnë, si edhe parimet e funksionimit të këtij sigurimi.<br>Rezulton se UV ka miratuar edhe Rregulloren e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë[90], sipas të cilës rregullohet veprimtaria e strukturave dhe njësive të ngritura, në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Në Rregulloren e UV[91] në nenin 62 të saj, sanksionohet e drejta e studentit që të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Në këtë nen saktësohet e gjithë procedura që duhet të ndiqet prej ankimit deri në dhënien përfundimtare të përgjigjes.<br>Në nenin 63 të Rregullores[92] sanksionohet e drejta e studentit, që nën kushte të caktuara, të ketë të drejtë që të përmirësojë notën në çdo lëndë.<br>Në faqen zyrtare të UV[93], gjendet i publikuar edhe Raporti i Analizës së Pyetësorëve të studentëve për vitin akademik 2019-2020. Raporti është i plotë dhe i detajuar për çdo njësi kryesore dhe për çdo program studimi. Raporti paraqet nivelin e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor, analizën e të dhënave, si edhe komentet e studentëve. |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Siç u përmend në kriterin 3 të Standardit III.1, Raporti i Analizës së Pyetësorëve të studentëve për vitin akademik 2019-2020 gjendet i botuar në faqen zyrtare të UV[94] dhe mund të aksesohet me lehtësi si nga studentët, ashtu edhe nga çdo person tjetër i interesuar. |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të | Në Raportin vjetor të UV për vitin 2018-2019[95], në zërin *Të dhëna mbi Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë*, vihet theksi se vlerësimet e studentëve janë jo vetëm detyrim ligjor, por edhe një |

89 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

90 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e SBC", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.14. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

91 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

92 ibid

93 http://univlora.edu.al

94 http://univlora.edu.al

95 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies. | burim shumë i rëndësishën informacioni për rritjen e cilësisë së veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore.<br>Personeli akademik ka përfituar rimbursimin e shpenzimeve për kërkimin shkencor apo për pjesëmarrje në konferenca shkencore apo publikime në revista shkencore. Disa pedagogë të Departamentit të Edukimit kanë marrë pjesë në kuadër të Programit "Erasmus+" apo në projekte të tjera. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| Standardi III.2<br>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Rregullorja e DE[96] në nenin 14 të saj përcakton se në format e mësimdhënies përfshihen:<br>– Leksioni: Në formë ligjërimi, duke përdorur formatin pyetje-përgjigje apo i kombinuar me ligjërimin, duke bërë prezantim në PoëerPoint, duke kombinuar dy ose më shumë nga format e mësipërme.<br>– Seminari: Shtjellon çështjet e trajtuara gjatë leksionit, përmes ushtrimeve, detyrave, pyetjeve, etj.<br>– Praktika në terren.<br>– Praktika mësimore/profesionale: Përfshin atashimin e studentëve pranë institucioneve mësimore/profesionale. Gjatë praktikës, ecuria e punës së studentëve ndiqet nga një lektor.<br>– Studimi individual lidhet me angazhimin personal të studentit. Format më të zakonshme të studimit individual janë studimi për përgatitje seminari apo provimi, punime relacionesh, detyrash apo projektesh kërkimore, ese, prezantime, përgatitja e temës së diplomës.<br>– Forma të tjera të studimit përfshijnë leksionet me lektorë të ftuar, workshop-e, seminare, apo konferenca shkencore. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e | Nga biseda me personelin akademik si edhe me përfaqësues të studentëve, u konstatua se në UV përdoreshin praktikisht të gjitha format e mësimdhënies dhe të nxënies të përmendura në Kriterin 1 të Standardit III.2.<br>Personeli akademik përdor ato forma të mësimdhënies që ishin më të përshtatshme me natyrën apo llojin e lëndës që zhvillohej. |

[96] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. | |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. | UV ka hartuar Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve[97]. Në këtë udhëzues, midis të tjerash përfshihen:<br>– modele të mësimdhënies;<br>– modele të mësimdhënies inovative;<br>– mësime demonstrimi në programe të mësuesisë;<br>– metodat e vendimmarrjes;<br>– vlerësimi i të nxënit të studentit;<br>– vlerësimi i mësimdhënies së lektorit;<br>– modele didaktike dhe pedagogjike.<br>Nga biseda me drejtues, personel akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se këto metoda zotërohen nga personeli akademik dhe zbatohen në praktikë. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit. | Është theksuar edhe më sipër në këtë RVJ se stafi akademik i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" i përmbush kriteret ligjore dhe akademike të kualifikimit profesional[98].<br>Në raportin e botuar në faqen zyrtare të UV[99], prej Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional për vitin 2019-2020, lidhur me vlerësimin e personelit akademik të DE që mbulon programin e studimit, rezulton se studentët i janë përgjigjur pozitivisht të gjitha pyetjeve lidhur me metodat e mësimdhënies dhe kompetencën e stafit akademik me tregues mbi 90%[100].<br>Gjithashtu, nga biseda me drejtues dhe personel akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se të gjitha metodat e mësimdhënies, të parashikuara në Udhëzuesin për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, zotërohen nga personeli akademik dhe zbatohen në praktikë. |

97 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

98 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1, Tabelat 6.1. 6.2, 6.3, 6.4, 7 të Aneksit 1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

99 https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2020/11/Raporti-i-Pyetësorëve-FSHH-2019-2020.pdf

100 https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2020/11/Raporti-i-Pyetësorëve-FSHH-2019-2020.pdf. Faqet 34-43.

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Në raportin e botuar në faqen zyrtare të UV[101], prej Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Vlerësimit Institucional për vitin 2019-2020, në faqen 43 të raportit, studentët shprehen:<br>– Mësimi ishte tërheqës ndërsa studentët të pavëmendshëm;<br>– Nuk më pëlqen pjesëmarrja jo aktive e të gjithë studentëve;<br>– Sugjerohet pjesëmarrja më aktive e studentëve.<br>Rezulton se duhet të bëhet më shumë për të përfshirë në mënyrë aktive studentët në procesin e mësimdhënies. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit. | Rregullorja e DE[102] në nenin 14 të saj përcakton forma të ndryshme të mësimdhënies interaktive si leksione duke përdorur formatin pyetje-përgjigje apo edhe pjesëmarrjen në ëorkshop-e, apo konferenca shkencore.<br>Nga biseda me drejtues dhe personel akademik efektiv, si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se nga personeli akademik zotërohen dhe zbatohen në praktikë disa metoda interaktive të mësimdhënies. |
| **Kriteri 7.** Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Studentëve u jepet mundësi zgjedhjeje në rastet e zhvillimit të detyrave të kursit apo të projekteve të ndryshme. Në këto raste, studentët kanë patur mundësi që të zgjedhin tema të caktuara midis një grupi më të gjerë temash në dispozicion të tyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.3**<br>**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen | Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, grupi i ekspertëve të jashtëm nuk pati mundësi që të shihte në prezencë fizike hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor-laboratorik. I gjithë procesi mësimor i Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zhvillohet në mjediset e Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH). Megjithatë, nga |

101 https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2020/11/Raporti-i-Pyetësorëve-FSHH-2019-2020.pdf

102 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| rregullisht. | stafi i UV u mundësua që të vëzhgoheshin me kamera të gjitha ambjentet. Nga këto vëzhgime, u konstatua se hapësirat e realizimit të procesit mësimor, pranë FSHH, janë të mjaftueshme dhe cilësore.<br>Gjithashtu, sipas Tabelës nr.16 të Aneksit të RVB103, rezulton se sasia e sipërfaqes fizike në dispozicion të FSHH (që mbulon programin e studimit) është 2.8m$^2$/student, që është në harmoni me kërkesat e VKM nr.418, datë 10.5.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre". |
| **Kriteri 2.** Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor. | Siç u theksua më sipër, për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, grupi i ekspertëve të jashtëm nuk pati mundësi që të shihte në prezencë fizike hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor-laboratorik. Megjithatë, nga stafi i UV u mundësua që të vëzhgoheshin me kamera të gjitha ambjentet. Nga këto vëzhgime, u konstatua se hapësirat e realizimit të procesit mësimor pranë FSHH, janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme. |
| **Kriteri 3.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor. | Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, grupi i ekspertëve të jashtëm nuk pati mundësi që të shihte në prezencë fizike hapësirat ku zhvillohet procesi mësimor. Sipas Tabelës nr.16 të RVB104, rezulton se në dispozicion të studentëve është një sallë interneti me sipërfaqe 90m$^2$.<br>Sipas Tabelës nr.17 të RVB105, UV në faqen zyrtare të tij https://univlora.edu.al ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, *University of Vlora Menagment System,* https://uvms.univlora.edu.al.<br>Gjithashtu, sipas Tabelës nr.17 të RVB106, në Godinën B të FSHH sigurohet lidhje e përhershme internet me rrjet fiks dhe WiFi. |
| **Kriteri 4.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin | Në UV, tekstet mësimore të rekomandueshme për pjesën teorike dhe të detyrueshme, duhet të miratohen nga departamenti, me propozim të titullarëve të lëndëve. Këto u bëhen të njohura studentëve me fillimin e vitit akademik107.<br>Të gjitha lëndët e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zhvillohen në gjuhën shqipe.<br>Literaratura bazë dhe ndihmëse përcaktohet në çdo program lëndor108 dhe ofrohet kryesisht në gjuhën Shqipe (por edhe në gjuhë të huaj), si edhe përditësohet vazhdimisht prej titullarit të lëndës. |

103 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

104 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

105 Ibid

106 Ibid

107 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar, neni 49", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

108 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1, Syllabuset e lëndëve", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| e studimit. | |
| **Kriteri 5.** Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor. | Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, grupi i ekspertëve të jashtëm nuk pati mundësi që të shihte në prezencë fizike hapësirat e Bibliotekës apo të verifikonte nëse në Bibliotekë gjendet një numër i mjaftueshëm i botimeve të viteve të fundit.<br>Sipas Tabelës nr.16 të Aneksit të RVB[109], pranë FSHH funksionon edhe Biblioteka me një sipërfaqe prej 130$m^2$. |
| **Kriteri 6.** Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit. | Në faqen zyrtare të UV është funksionale edhe Biblioteka online (https://ulibrary.rash.al), për të cilën është funksional edhe Manuali i Përdorimit (https://univlora.edu.al/ëp-content/uploads/2019/04/Manual_Ulibrary.pdf).<br>Aksesi për në Bibliotekën online mundësohet në mënyrë individuale përmes llogarive personale dhe përmes saj personeli akademik si edhe studentët kanë mundësi përzgjedhje sipas fushës së tyre të studimit apo të interesit. |
| **Kriteri 7.** Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët. | Për shkak të situatës së krijuar si rezultat i efektit të Pandemisë Covid-19, rezulton se shfrytëzimi aktual i infrastrukturës së FSHH ka qënë kushtëzuar nga zbatimi i protokolleve sanitare antiCovid.<br>Nga biseda me personelin akademik si edhe me përfaqësues të studentëve, rezulton se në kushte normale të jetës universitare, infrastruktura e FSHH shfrytëzohet mjaftueshëm prej studentëve, në varësi të zbatimit të planit mësimor. |
| **Kriteri 8.** Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre. | Sipas Tabelës nr.17 të RVB[110], UV në faqen zyrtare të tij https://univlora.edu.al ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, *University of Vlora Menagment System,* https://uvms.univlora.edu.al.<br>Sipas këtij sistemi, mundësohet komunikimi i personelit akademik me studentët për çdo lëndë të Programit të Studimit. Ky komunikim realizohet përmes llogarive personale të çdo studenti (emër.mbiemër@univlora.edu.al). |
| **Kriteri 9.** Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm | Në platformë, çdo pedagog i lëndës mund të ngarkojë materiale mësimore (leksione, detyra të ndryshme, prezantime, etj) që mund të aksesohen në çdo kohë nga çdo student i veçantë. Për këtë, çdo personel akademik ka në dispozicion hapësirën e vet individuale, në |

109 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

110 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar. | të cilën ai mund të ngarkojë leksionet e lëndës/modulit, syllabusin, si edhe mënyrën e administrimit të lëndës përgjatë gjithë semestrit. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre. | Sipas Rregullores së Programit të Studimit[111], të drejtën për punuar temën e diplomës e kanë vetëm studentët me notë mesatare mbi 9.0. Fusha e studimit dhe e kërkimit, si edhe etika e kërkimit shkencor, përcaktohet në Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV[112]. Studentët njihen me temat e kërkimit dhe më pas kanë të drejtë të zgjedhin fushën që ata dëshirojnë, si edhe pedagogun udhëheqës. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. | Pranë UV është ngritur dhe është funksionale Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit Institucional, e ngritur sipas vendimit të Senatit Akademik të UV[113], si strukturë që koordinon dhe bashkërendon aktivitetet midis njësive bazë dhe asaj kryesore në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>Gjithashtu, UV ka hartuar Udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve[114]. |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli | Në Rregulloren e DE[115], në nenin 7, parashikohet ngritja e grupeve mësimore të përhershme dhe/ose të përkohshme me karakter kërkimor-shkencor. Në këtë nen, parashikohen edhe detyrat e këtyre grupeve, fusha e veprimtarisë së tyre, si edhe |

111 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

112 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca F, Rregullore e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV", ASCAL, Dok. nr.54. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

113 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.1", Vendim i Senatit Akademik të UT "Ismail Qemali, Vlorë, nr.84, datë 12.12.2016 Për ngritjen e NJSBCVI", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

114 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

115 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron. | mënyra e funksionimit të tyre.<br>Të gjithë pjesëtarët e stafit akademik të Departamentit të Edukimit, por edhe pedagogët e tjerë që zhvillojnë mësim në këtë program, i diskutojnë konkluzionet e tyre gjatë analizave vjetore të punës mësimore dhe veprimtarisë shkencore, me qëllim kryesor përcaktimin e nevojave të studentëve dhe përmirësimin e procesit mësimor. |
| **Kriteri 3.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. | Nga bisedat me pedagogët, si edhe me studentët, u konstatua se në situatën e pandemisë në vitin 2020, por jo vetëm, në dispozicion të të gjithë stafit akademik janë vendosur manuale të mësimit online[116] si edhe janë zhvilluar trajnime të stafit lidhur me metodat e reja të mësimdhënies.<br>Gjithashtu, në dispozicion të personelit akademik, si edhe të studentëve, është edhe Udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve[117]. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | I gjithë personeli akademik në përbërje të Departamentit të Edukimit ka kryer kurse trajnimi me afate të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Kualifikimet dhe vlerësimet e tyre monitorohen përmes plotësimit të formularëve specifikë. Gjithashtu, në fund të çdo viti akademik UV boton raportin vjetor[118], në të cilin trajtohen me hollësi veprimtaria kërkimore-shkencore përgjatë një viti akademik. Tabela nr.19 dhe nr.20 e Aneksit të RVB[119] pasqyron me hollësi numrin e personelit akademik që ka marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit, apo që ka botuar artikuj në revista të ndryshme shkencore. |
| **Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja. | Siç përmendet edhe në RVB[120], UV nuk ka njësi përgjegjëse për trajnimin e personelit akademik. Por ndihma e UV për personelin akademik ka rezultuar:<br>- Përmes mundësimit të trajnimit me anë të programeve ERASMUS+ (apo programeve të tjera të ngjashme me të);<br>- Përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të personelit akademik duke mbuluar kostot e tyre financiare për botime apo për pjesëmarrje në konferenca të ndryshme shkencore jashtë vendit. |
| **Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli | Në Rregulloren e DE[121], në nenet 9, 10, si edhe 11, përcaktohen me hollësi detyrat dhe detyrimet e personelit akademik efektiv dhe |

[116] Manual i Studentëve dhe Manuali i Pedagogut gjenden në: https://univlora.edu.al/en/manuale

[117] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[118] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[119] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[120] Ibid

| | |
|---|---|
| ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja. | të atij me kontratë për zbatimin e programeve të studimit.<br>Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, është detyrim i personelit akademik edhe zbatimi i Udhëzuesit në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve[122]. |
| **Kriteri 7.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse. | Në dispozicion të personelit akademik është Udhëzuesi në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe innovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve[123].<br>Në fund të çdo viti akademik bëhet analiza në rang njësie bazë, më pas në rang njësie kryesore dhe në fund, në rang institucioni. Të dhënat e dala nga këto analiza, përmblidhen së bashku edhe me problematika të tjera në raportin që UV boton në fund të çdo viti akademik.[124] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Në Rregulloren e UV[125] parashikohet se:<br>- Kontrolli i dijes së një lënde (përmes provimit) përcaktohet nga titullari i lëndës dhe mund të bëhet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim e me gojë, duke u mbështetur në programin mësimor. Në UV kontrolli i dijeve në ciklin e parë të studimeve realizohet përgjatë semestrit nëpërmjet një provimi të pjesshëm, një provimi final gjithë përfshirës si dhe formave te tjera të vlerësimit nëse janë parashikuar në syllabus-in e lëndës. |

121 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

122 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

123 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

124 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

125 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | – Rregulla apo specifika të provimeve, pesha (përqindja) e secilit provim apo detyre në vlerësimin përfundimar, literatura, temat ose pjesët e programit të lëndës për çdo provim, dita apo java e provimit, ora dhe salla e zhvillimit, referencat e konvertimit të pikëve në notë etj, përcaktohen në syllabus-in e lëndës të hartuar nga pedagogu dhe u bëhet i ditur studentëve që ndjekin atë kurs. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Syllabuset e lëndëve[126] në një rubrikë të veçantë (Forma e Kontrollit të Dijeve) paraqesin:<br>– Masën e frekuentimit të detyrueshëm dhe numrin e mungesave të lejuara;<br>– Vlerësimin, në pjesën më të konsiderueshme të lëndëve, realizohet përmes provimit të pjesshëm (30 pikë), vlerësimit vjetor (10 pikë), si edhe përmes provimit final (60 pikë). |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Në Rregulloren e DE[127], në nenin 15 (Kontrolli i dijeve), parashikohet se:<br>– Kontrolli i dijes realizohet në forma të larmishme, me gojë, me shkrim, ose të kombinuara, gjatë gjithë semestrit.<br>– Këto forma parashikohen në syllabusin e kursit nga titullari i tij. Ato mund të përfshijnë provime të pjesshme, si edhe një provim final.<br>– Përveç provimeve përdoren edhe forma të tjera si detyra kursi, prezantime, ese, projekte kërkimore, etj. Secila formë kontrolli, e përcaktuar në syllabus nga titullari i kursit, zë një përqindje të caktuar në vlerësimin përfundimtar të studentit. Vlerësimi përfundimtar është produkt i shumës së vlerësimeve të marra në secilën formë të kontrollit. Konvertimi i përqindjeve të fituara nga vlerësimet e marra në notë përcaktohen në syllabus.<br><br>Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"[128] përcaktohen rregulla më të detajuara për:<br>– Mënyrën e kontrollit të dijeve (neni 14);<br>– Të drejtën e Ankimit të studentëve (neni 15);<br>– Të drejtën e përmirësimit të notës (neni 16);<br>– Masën e frekuentimit të leksioneve, seminareve, si edhe laboratorëve (neni 17);<br>– Detyrimin për të ndjekur praktikën profesionale (neni 18);<br>– Detyrimin për marrë pjesë në provimin e diplomës, ose për të zhvilluar një temë diplome në rastet kur mesatarja e provimeve të mëparshme ka qënë mbi 9.0 (neni 19); |

[126] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1, Syllabuset e lëndëve", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[127] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[128] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik. | Siç parashikohet edhe në syllabuset e lëndëve[129], vlerësimi i studentëve bëhet i vazhduar përgjatë gjithë vitit. Kështu, vlerësimi, në pjesën më të konsiderueshme të lëndëve, realizohet përmes provimit të pjesshëm (30 pikë), vlerësimit vjetor (10 pikë), si edhe përmes provimit final (60 pikë). |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Sipas Tabelës nr.17 të RVB[130], UV në faqen zyrtare të tij https://univlora.edu.al ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, *University of Vlora Menagment System,* https://uvms.univlora.edu.al, por, siç pranohet edhe në RVB, në UV nuk ka në zbatim një sistem elektronik testimi dhe vlerësimi të studentëve. |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit. | Nga bisedat e zhvilluara online me pjesëtarë të personelit akademik, me drejtues të UV, por edhe nga bisedat me përfaqësues të studentëve, rezulton se është praktikë që komisionet e provimeve përbëhen së paku nga dy anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës. Por, një detyrim i tillë nuk figuron i shprehur në Rregulloren e DE, në Rregulloren e Programit të Studimit, apo në ndonjë dokument tjetër rregullator.<br>***Rekomandohet*** *që në dokumentet rregullatore të përfshihet detyrimi që komisionet e provimeve të përbëhen së paku nga dy anëtarë, ku të paktën njëri prej tyre të jetë titullari i lëndës.* |
| **Kriteri 4.** Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi. | Siç pranohet edhe në RVB, në UV testimi i vlerësimit me shkrim i njohurive dhe i dijeve nuk zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim. Gjithashtu, institucioni nuk disponon infrastrukturë të posaçme dhe të pajisur me mjete survejimi. |

129 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1, Syllabuset e lëndëve", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

130 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Në Rregulloren e UV131, në nenin 61 parashikohet e drejta e çdo studenti që të njihet personalisht me provimin në prani të lektorit të kursit.<br>Nga bisedat e zhvilluara me pjesëtarë të personelit akademik, me drejtues të UV, por edhe nga bisedat me përfaqësues të studentëve, rezulton se pedagogët e lëndës japin komente/feedback lidhur me procesin e të nxënit dhe për përmirësimin e tij në të ardhmen. |
| **Kriteri 6.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik. | Në UV është funksional Kodi i Etikës132 dhe Rregullorja e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV133. Në Kodin e Etikës, në nenin 9 (sjelljet e ndaluara) theksohet se ndalohet plagjiatura e çdo lloji.<br>Rezulton, gjithashtu, se në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH"134, në nenin 51 (Shkeljet dhe masat disiplinore), theksohet se ndaj studentit që kryhen kopjim gjatë një provimi, mund të merren disa masa disiplinore, duke filluar nga vërejtje me shkrim e deri në përjashtim përgjithmonë nga UV. |
| **Kriteri 7.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Në Kodin e Etikës135, në nenin 5 (detyrimet e personelit) theksohet se personeli akademike duhet:<br>– Të mos lejojë që marrëdhëniet personale të prekin marrëdhëniet profesionale (pika 17);<br>– Të mos kërkojë dhe të mos pranojë privilegje, përfitime, favorizime, që kanë për qëllim marrjen e rezultateve favorizuese;<br>– Të mos bëjë dallime ndër studentë, për shkak të njohjeve apo preferencave personale.<br>Siç është përmendur më sipër në këtë RVJ, në Rregulloren e UV136 në nenin 61 të saj, sanksionohet detyrimi i personelit akademik që të publikojë rezultatet e çdo detyre apo provimi brenda 48 orëve, me pasojë marrjen e masave disiplinore kundrejt personelit akademik. |
| **Kriteri 8.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në | Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"137 përcaktohen rregulla më të detajuara për:<br>– Të drejtën e Ankimit të studentëve (neni 15);<br>– Të drejtën e përmirësimit të notës (neni 16); |

131 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
132 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca E, Kodi i Etikës", ASCAL, Dok. nr.53. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
133 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca F, Rregullore e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV", ASCAL, Dok. nr.54. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
134 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH", ASCAL, Dok. nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
135 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca E, Kodi i Etikës", ASCAL, Dok. nr.53. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
136 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
137 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Gjithashtu, në Rregulloren e UV[138], në nenin 61 parashikohet e drejta e çdo studenti që të njihet personalisht me provimin në prani të lektorit të kursit. |
| **Kriteri 9.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. | Në Rregulloren e UV[139], në nenin 62 theksohet se studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin e provimit. Procedura e ankimit vijon në këtë mënyrë:<br>– Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga marrja dijeni e rezultatit të provimit.<br>– Nëse përgjegjësi i departamentit nuk mundëson zgjidhjen e ankesës, atëhere vihet në lëvizje Dekani, i cili brenda 48 orëve nga marrja në dorëzim e ankesës prej përgjegjësit të departamentit ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit.<br>– Me miratimin e Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi III.7**<br>**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët,duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Në Planin Mësimor të Programit të Studimit[140] janë përcaktuar objektivat e këtij programi studimi, të cilat synojnë:<br>– ofrimin e njohurive të përgjithshme dhe specifike të mbështetura në lëndë të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisplinore, si edhe plotësuese;<br>– përgatitjen e mësuesve të arsimit parashkollor të aftë që të integrohen në proceset e mësimdhënies në institucione me karakter specifik në fushat përkatëse. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit | Në Planin Mësimor të Programit të Studimit[141] parashikohet |

138 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

139 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

140 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq



| | |
|---|---|
| garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | zhvillimi i lëndëve të tilla si Gjuhë e Huaj (Viti i parë), Edukatë Qytetare (Viti i parë), Psikologji (Viti i parë deri në të tretin), Komunikim (Viti i tretë), etj, të cilat mundësojnë zhvillimin e aftësive të veçanta në fushat përkatëse. UV në faqen zyrtare të tij https://univlora.edu.al ka të përfshirë edhe Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, *University of Vlora Menagment System,* https://uvms.univlora.edu.al. Sipas këtij sistemi, mundësohet komunikimi i personelit akademik me studentët për çdo lëndë të Programit të Studimit. Në platformë, çdo pedagog i lëndës mund të ngarkojë materiale mësimore (leksione, detyra të ndryshme, prezantime, etj) që mund të aksesohen në çdo kohë nga secili student i veçantë. Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemeve të tilla u mundëson studentëve zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit. |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde. | Kompetencat dhe aftësitë që fitojnë studentët në fund të çdo lënde, tregohen kryesisht me rezultatet e arritura prej tyre përmes formave të ndryshme të vazhdueshme të testimit, si edhe përmes arritjeve në provimin përfundimtar. |
| **Kriteri 4.** Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre. | Nga shqyrtimi i syllabuseve u konstatua se personeli akademik është i angazhuar me evidentimin e çështjeve më të rëndësishme dhe që kërkojnë një vëmendje të mëtejshme në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënit[142]. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit. | Nisur nga situata pandemike që ka ekzistuar dhe ekziston akoma në Shqipëri, për shkak të kufizimeve ligjore, personeli akademik e ka patur të pamundur që të realizojë orë të hapura apo seminare të zgjeruara. |
| **Kriteri 6.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. | Mësimdhënia realizohet mbi bazën e kompetencave, në mënyrë që studentët të zhvillojnë njohuritë e marra.<br>Gjithashtu, në kuadër të bashkëpunimit, UV ka nënshkruar edhe marrëveshjen për bashkërendimin e praktikave mësimore dhe të veprimtarive mësimore (Janar 2018) me Drejtorinë Arsimore Rajonale-Vlorë[143], (sot Zyra Vendore Arsimore Vlorë), sipas të cilës përcaktohen veprimtaritë në të cilat do të angazhohen të dy institucionet, si edhe detyrimet e dyanshme të secilit institucion. |

141 Ibid

142 Ibid

143 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.5,", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 7.** Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara. | Nga shqyrtimi i RVB-së[144], konstatohet se stafi akademik inkurajohet që në mënyrë të vazhduar të diskutojë dhë të punojë në grup mbi interpretimin apo zgjidhjen e çështjeve të caktuara si p.sh., të shkëmbejë eksperienca të ndryshme të metodave të mësimdhënies dhe të të nxënit me anë të diskutimeve të ndryshme. |
| **Kriteri 8.** Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. | Nisur nga shqyrtimi i gjithë bazës dokumentare të depozituar nga Institucioni, rezulton se Institucioni në parim nxit dhe mbështet zhvillimin e ideve inovatore si edhe studimet e avancuara shkencore, por nuk ka fonde të mjaftueshme financiare. |
| **Kriteri 9.** Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët. | Siç përmendet edhe në RVB[145], dhe nga të dhënat e marra nga bisedat me personelin akademik të Deparatmentit të Edukimit, i cili mbulonte këtë program studimi, Insitutcioni ka mbështetur financiarisht personelin akademik për promovimin e tyre professional, por mbështetja financiare për studentët ka qënë modeste. |
| **Kriteri 10.** Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Personeli akademik i UV ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione të huaja kanë në objekt fushën e edukimit.[146] Në këtë kuadër, ka patur një mobilitet të kënaqshëm të personelit akademik kryesisht në pjesëmarrje në konferenca shkencore apo në kuadër të programit ERASMUS+ (apo në programe të ngjashme me të). Ndërsa mobiliteti i studentëve, siç përmendet edhe në RVB[147], ka qënë në nivel të ulët, kryesisht për shkak të shkallës së ulët të interesit të treguar prej tyre. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.8**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

144 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

145 Ibid

146 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018-2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

147 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike. | Sipas Rregullores së Programit të Studimit[148], të drejtën për punuar temën e diplomës e kanë vetëm studentët me notë mesatare mbi 9.0. Në nenin 19 të rregullores përcaktohen procedurat që duhet të ndiqen prej caktimit të temës së diplomës apo provimit, deri në vlerësimin me notë të studentëve. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës. | U konstatua se personeli akademik i Departamentit të Edukimit përgatit dhe vendos në dispozicion të studentëve Bankën e pyetjeve të provimit të formimit gjatë semestrit të parë të vitit të tretë. Banka e pyetjeve[149] përmban pyetje bazë nga të gjitha lëndët e mësuara përgjatë tre viteve të studimit dhe bazuar në këtë fond, hartohet edhe teza e provimit të formimit. Gjithashtu, departamenti harton listën e fushave prioritare të kërkimit dhe miraton temat e përzgjedhura në studentët si edhe listën e pedagogëve udhëheqës, nisur edhe nga propozimet e bëra nga studentët. |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final përbëhet nga 5 anëtarë që janë pedagogë të fushave kryesore të programit të studimit. Teza e provimit hartohet në bashkëpunim midis tyre duke u kujdesur që të përmbajë pyetje thelbësore nga të gjitha lëndët/modulet e zhvilluara përgjatë tre viteve të studimit. Teza e provimit[150] hartohet në bazë të bankës së pyetjeve[151], e cila u është bërë e njohur paraprakisht studentëve. Ndërsa vlerësimi i temës së diplomës bëhet përmes përdorimit të sistemi me pikë, i cili vlerëson me pikë elementët kryesorë të temës së paraqitur nga studenti. |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. | Personeli akademik orienton studentët për përgatitjen e provimit final duke vënë në dispozicion të tyre fondin e plotë të pyetjeve qysh në semestrin e parë të vitit të tretë.<br>Personeli akademik me cilësinë e udhëheqësit të temave të diplomës, komunikon vazhdimisht me studentët, drejtpërsëdrejt apo përmes mjeteve elektronike, për të gjitha hapat që duhen ndjekur apo për çdo problem që del gjatë zhvillimit të temave të diplomës. |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave | Nga diskutimet e realizuar me përfaqësuesit e studentëve gjatë takimit virtual në Zoom, u konstatua se pedagogët sipas moduleve që ofrojnë, asistojnë studentët gjatë orëve praktike në mjediset e UV apo në orët praktike që ato realizojnë në institucionet pritëse me të cilat institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi. |

148 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Rregullore e Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë nr.7. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

149 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.9, Banka e pyetjeve për diplomimin e studentëve në arsimin parashkollor", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

150 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.10, Tezat e provimit përfundimtar për mbrojtjen e diplomës Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.31. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

151 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.9, Banka e pyetjeve për diplomimin e studentëve në arsimin parashkollor", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| dhe fushës së studimit. | |
| **Kriteri 6.** Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Rezultoi se është praktikë e konsoliduar në UV, se Udhëheqësi i Temës së Diplomës, i cili miratohet prej drejtuesit të DE, ndjek dhe asiston studentin përgjatë gjithë periudhës së zhvillimit të temës së diplomës dhe miraton paraprakisht punimin, duke konkluduar se punimi plotëson të gjitha kushtet formale për t'u paraqitur përpara komisionit.<br>Rezultoi, gjithashtu, se në UV nuk ka në qarkullim udhëzues (apo manuale) që normojnë shkrimin e një teme diplome prej fillimit të saj e deri në përfundimin dhe paraqitjen përpara komisionit.<br>***Rekomandohet*** *hartimi i udhëzuesve (apo manualeve) që do të shërbejnë si udhërrëfyes për studentët për zhvillimin e temave të diplomës.* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Sipas Rregullores[152] së Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", vlerësimi i studentëve në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës bëhet me notë.<br>Vlerësimi i punimeve të diplomave të studentëve bëhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe nota e vendosur është sa mesatarja e vlerësimit nga të gjithë anëtarët e komisionit. |
| **Kriteri 8.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. | Në përfundim të studimeve për Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", studenti pajiset me diplomën përkatëse dhe suplementin e notave[153], sipas formatit të miratuar nga MASR. |
| **Kriteri 9.** Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Sipas kërkesës së studentit, në përfundim të studimeve atij i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor". |
| **Kriteri 10.** Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. | E gjithë praktika përmbyllëse e programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" mbulohet nga Sekretaria Mësimore e FSHH sipas detyrimeve ligjore të përcaktuara në Rregulloren e UV[154] (neni 54 i saj). Edhe përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale bëhet sipas kërkesave të neneve 88 dhe 89 të kësaj rregulloreje. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

[152] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Plani Mësimor i Programit të Studimit", ASCAL, Dokumentet shtesë, evidenca nr.3. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[153] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.6, Model Diplome dhe Suplementi i Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.16. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[154] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ. | Konstatuam nga shqyrtimi RVB dhe takimet online nëpërmjet paltformës Zoom se institucioni mbledh dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit akademik sipas nevojave të propozuara nga departamenti. Drejtoria e komunikimit dhe burimeve njerezore[155] menaxhon dosjet e personelit akademik, ndihmës akademik dhe admistrativ si dhe harton dhe ndjekt proceduart për rekrutimet e reja.<br>Departamenti i Edukimit mbledh, ruan dhe përditëson angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik te përfshirë në program dhe personat përgjegjës për organizimin e programit të studimit[156]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit. | Konstatuam se DE në bashkëpunim me Drejtorinë e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore harton dhe zbaton procedura të përgjithshme dhe specifike (të përcaktuara nga departamenti i edukimit) për përzgjedhjen e personelit në përputhje me nevojat e programit[157]. Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore shpall thirrjen online për vendin vakant, përgatitjen e komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe në aktet e brendshme të rregullores së UV[158]. |

[155] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[156] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[157] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[158] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

<table>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</td><td colspan="4">Rezulton se çdo fillim viti akademik DE paraqet nevojat e njësisë për staf akademik, mbështetur në plan ngarkesën[159] miratohet në Dekanat dhe i çohet për miratim Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit, shoqëruar me arsyetimin përkatës. Më pas Institucioni harton procedura e kritere specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike[160].</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</td><td colspan="4">Konstatuam se vlerësimi për përzgjedhjen e personelit akademik kryhet nga një komision ad-hoc i ngritur nga Rektori i UV, me 5 anëtar[161]:<br>3 përfaqësues nga vetë departamenti,<br>1 përfaqesues i dekanatit,<br>1 përfaqësues i rektoratit.<br><br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll-arkivës, ndjek të gjitha procedurat dhe administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DE[162]. Bazuar ne kuadrin ligjor ajo arkivon dosjet përkatëse për çdo anëtar të PAE dhe PAK, Ndërsa marrëveshjet kontraktuale të organizimit të kohës së punës të stafin akademik arkivohen pranë Drejtorisë së Edukimit.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.2<br>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efiçente dhe efektive</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
</table>

[159] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor- Tabela 4", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[160] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor- Tabela 4", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[161] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.1, Procedura e departamentit për personel akademik", ASCAL, Dok. nr.33. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[162] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedura e rekrutimit të stafit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. | Nga shqyrtimi i RVB[163] dhe takimi online me Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore konstatuam që institucioni zbaton procedura ligjore për përzgjedhjen e personelit në perputhje me nevojat e e programit të studimit.<br>DE në bashkëpunim me Drejtoria e komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore harton procedurat për shhpalljen e thirrjes online, përgatitjes se komisionit të vlerësimit, i cili merr vendimin në bazë të kritereve specifike të përcaktuara nga nevojat e programit të studimit që departamenti ka dhe aktet e brendshme të rregullores së UV[164]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit. | Nga takimi virtual me Përgjegjësen e Departamentit të Edukimit konstatuam se vetë departamenti përditëson në mënyrë të vazhdueshme të dhëna që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik[165], CV e tyre akademike, marrëveshja e organizimit të kohës vjetore[166], formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore.<br>Nga ana tjetër Drejtoria e Burimeve Njerëzore administron ruajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit të personelit akademik të DE[167]. Ajo arkivon dosjet përkatëse të personelit akademik, si dhe të marrëveshjevet e nënshkruara me stafin akademik në përfundim të gjithë procesit të rekrutimit.<br>Stafi akademik është i angazhuar për kualifikim të vazhdueshëm profesional brenda dhe jashtë vendit[168]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor. | Konstatojmë se institucioni është angazhuar para por edhe gjatë periudhës së pandemisë për kualifikimin e vazhdueshëm[169] dhe zhvillimin profesional të personelit për metodat inovative të mësimdhënies si dhe të përdorimit të teknologjive të reja. UV ka miratur në Janar të vitit 2020 Udhëzuesin mbi zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies[170]. Gjithashtu janë organizuar trajnime për përdorimin e teknonologjive të reja në mësimdhënies si dhe ngritja e sistemit të brendshëm informues UVMS[171]. |

[163] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[164] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[165] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.3 Shkresa për miratimin e Strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2022,", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[166] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[167] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedura e rekrutimit të stafit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[168] Universiteti "Ismail Qsemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.8, Mobiliteti i stafit", ASCAL, Dok. nr.29. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[169] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca G, Strategjia Për Trajnimin e Vazhdueshëm të Kërkuesve të Rinj", ASCAL, Dok. nr.55. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[170] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca N, Udhëzues në nivel insitutucional për Zhvillimin dhe përdorimin e Metodave të ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies në Bazë të Fushës së Studimeve, Lëndëve/Moduleve", ASCAL, Dok. nr.62. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[171] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Institucioni dhe DE dëshmojne të kenë burimeve njerëzore të përthtatshme për përmbushjen e objektivave të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" dhe mjedise të përshtatshme për krijimin mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.<br>DE në çdo fillim viti akademik planifikon kohën vjetore të punës[172] për çdo anëtar të personelit akademik në të cilën përfshihet ngarkesa mësimore, kërkimi shkencor dhe angazhimi institucional në nivel grupi mësimor, departamenti e fakulteti. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Nga vizita virtuale e mjediseve të institucionit konstatuam se lëndët e programit Bachelor MAP zhvillohen në godinen B të Fakultetit të Shkencave Humane.<br>Në shërbim të këtij program studimi, në godinën B janë vënë në funksion 5 klasa leksioni në katin e parë dhe 4 klasa në katin e dytë.<br>2 klasa laboratorike janë vënë në dispozicion për zhvillimin e orëve praktike të kurseve si art muzikor dhe pamor të këtij program studimi[173].<br>Rezulton se institucioni siguron mjediset e përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike sipas grupeve mësimore. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Konstatuam se disa nga mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, biblioteka janë të pajisura me mjete elektronike të lëvizshme dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Fakulteti i Edukimit ka kapacitet infrastruktoror dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infasrtukturor për student.[174] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, | Nga vizita virtuale e mjediseve konstatuam se auditorët |

[172] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[173] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[174] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | mësimorë janë të pajisur me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor (banka, karrike, pajisje audiovizive, tabela etj.). Sallat e leksioneve në të cilat zhvillohen modulet e programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" janë të pajisura me videoprojektorë.<br>2 Laboratori i ngritur, në fazë rikonstruksioni, në mbështetje të këtij program studimi zotëron një sërë mjetesh dhe pajisjesh didaktike të cilat shfrytëzohen nga studentët për të kryer veprimtari të shumëllojshme në orët laboratorike[175].<br>Gjithashtu, gjatë vizitës virtuale në institucion konstatuam se mjediset mësimore si zyra, salle leksionesh, laboratorë, salle konferencash janë të pajisuara me mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të kurseve që ofron ky program studimi per aftësimit teorik dhe detyrat praktike formues të programit të studimit. |
| **Kriteri 4.** Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron. | Nga vizita virtuale në institucion dhe nga shqyrtimi i RVB[176] konstatojmë se insitucioni nuk disponon një laborator informatike por brenda bibliotekës së Godinës B ka një kënd me 15 vende të pasjisur me kompjetera.<br><br>*Rekomandohet që insitutcioni të sigurojë për studentët të paktën një laborator të teknologjisë së infomacionit të pajisur me programe profesionale në shërbim të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. | Institucioni ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë e Vlorës[177] për realizimin e praktikave mësimore të studentëve.<br><br>Gjithashtu institucioni ka realiuar marrëveshje bashkëpunimi me universitete të huaja si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjikë), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin-it (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj[178]., në të cilat dhe pedgaogët e Deparatemnti të Edukimit kanë shkëmbyer përvoja profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4** |
|---|

175 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.2, Infrastruktura e Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë", ASCAL, Dok. nr. 23 Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

176 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

177 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.5, Marrëveshje bashkëpunimi DAR Vlorë, 2018", ASCAL, Dok. nr.37. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

178 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Lista e plote e marreveshjeve nder institucionale" Parë në Shkurt 2021, gjendet në https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nderinstitucionale/.

| Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Konstatuam se intistucioni ka vënë në dispozicion të studentëve për këtë program studimi dy biblioteka: Biblioteka Qëndrore në godinën A ku ndodhet Rektorati dhe Biblioteka në Godinën B ku ndodhet dhe Fakulteti i Shkencave Humane. Studentët kanë të drejtë të regjistrohen të përdorin literaturën e nevojshme në mjediset e bibliotekave si të tërheqin gjithashtu literaturë për shfrytëzim jashtë mjediseve të bibliotekës[179]. Biblioteka Qendrore ka 15 vende ulëse dhe një pjesë e tavolinave janë të pajisura me kompjutera dhe internet.<br>Ndërsa nëpërmjet bibliotekës online: Ulilibrary.rash.al studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë literaturën e nevojshme për zhvillimin dhe pasurimin e njohurive teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet lëndëve të këtij program studimi. |
| **Kriteri 2.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Nga takimi virtual me Drejtorinë e Bibliotekës dhe bazuar në raportin vjetor të UV rezultoi se biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Institucioni ka vënë në dsipozicion një fond librash me 21769 libra në gjuhën shqipe, 13974 libra në gjuhë të huaj dhe 2148 periodike në gjuhën shqipe[180]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i RVB rezulton se institucioni në bashkëpunim me MARS ka vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën online: Ulibrary.rash.al pa pagesë[181]. Studentët dhe stafi akademik kanë mundësi të shfrytëzojnë libaritë online të fushave të ngjashme dhe të përafërta me programin e studimit në mënyrë që të pasurojnë njohuritë teorike dhe realizimin e punëve laboratorike që ofrohen nëpërmjet lëndëve të këtij program studimi. |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin | Ne vitin 2017 institucioni ka krijuar një sistem digjital të brendshëm të menaxhimit "UVMS"[182]- Ky sistem elektronik admnistron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, materialet shtesë, pikët dhe vlerësimet e studentëve. |

[179] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[180] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019, f.221", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[181] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[182] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve. | |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit. | Nga takimi virtual me stafin akademik dhe studentët konstatuam se studentëve u vihet gjithashtu në dispozicion fondi i librave të DE të cilin pedagogët e shfrytëzojnë si literaturë bazë në programet e moduleve që zhvillojnë. Fond i cili eshte krijuar vit pas viti si rezultat i dhurimeve të ndryshme të bëra nga shtëpitë botuese në vend dhe blerjeve të kryera në kuadër të bashkëpunimit që DE[183]. Institucioni ka paraqitur një dokument për tekstet që u vihen në dispozicion studentëve të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor, por nuk disponojmë një plan të detajuar stategjik për shtimin e zërave të bibliotekës.<br><br>*Rekomandojmë që institucioni të hartojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor.* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e UV ka vënë në dispozicion të studentëve orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, gjatë periudhës para pandemisë dhe gjatë këtij viti akademik biblioteka qendrore ka qënë në dispozocion të nevojave të studentëve nga 08.00- 20.00. Ndërsa Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Humane është në dispozicion të studentëve 08.00-16.00. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

183 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Kopjet e teksteve per dy programet e studimit", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | Rezulton se institucioni ka vënë në dispozicion sistemin digjital UVMS[184], ku studentët aksesojnë në çdo kohë për ofertat edukative, administative, kulturore dhe sportive[185] etj.<br>Gjithashtu konsatuam që sekretaria mësimore e FFHH disponon statistika vjetore:<br>• për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit[186];<br>• të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik;<br>• të dhëna për transferimet dhe çregjistrimet;<br>• të dhëna për ecurinë akademike të studentit;<br>• numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik,<br>• si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen. |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Bazuar në Raportit Vjetor të UV[187] rezulton se insitucioni disponon informacion të plotë për aktivitetin mësimor dhe atë kërkimor-shkencor të personelit akademik.<br><br>Zyra e burimeve njerezore disponon dhe arkivon dokumentacionin për personelin akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit[188]. Ndërsa DE dhe Drejtoria e Edukimit menaxhon nëpërmjet marrëveshjeve të përvitshme për organizimin e kohës së punës të stafit akademik[189]. |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nga takimi virtual me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo ruan të gjithë dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në UVMS dhe në formatin e Regjistrit Themeltar të Studentëve dhe Regjistrin e Diplomimit. Çdo e dhënë koordinohet me sistemin qëndror kombëtar dhe studenti regjistrohet përfundimisht vetëm pasi i njihet numri i matrikullimit. |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe | Nëpërmjet sistemit digjital UVMS[190] rezulton se institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale për regjistrimin përfundimtar në mënyrë që ata te aksesojnë atë në çdo kohë dhe të ndërveprojnë me personelin aktiv.<br>Sekretaria mësimore mban në sistem edhe të dhëna personale të |

[184] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[185] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[186] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[187] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[188] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Procedure rekrutim stafi", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[189] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.4 Marrëveshje për organizimin e kohës së punës, 2018,", ASCAL, Dok. nr.36. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[190] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| studentëve. | studentëve si numra telefoni, adresa emaili dhe ruan kontakte të vazhdueshëm me studentët në raste njoftimesh. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti, etj. |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët. | Rezulton se nëpërmjet UVMS institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ nëpërmjet aksesit që i jep dekanit dhe përgjegjësit të departamentit të kontrollojnë hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar.<br><br>*Rekomandohet hartimi i Raportit Vjetor të Veprimtarisë së DE në mënyrë që të garantojë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Konstatojmë se në faqen zyrtare të internetit të UV janë publikuar të dhëna në lidhje me strukturën organizative, veprimtaritë, bazën ligjor si dhe njoftimet te ndryshme që lidhen me veprimtarinë akademike të UV, në gjuhën shqipe dhe angleze.<br><br>*Në faqen zyrtare të UV nuk gjendet informacion mbi programet e studimit, personelin akademik dhe planet mësimore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Institucioni harton çdo fillim viti raportin financiar si pjesë e Raportit Vjetor të UV[191] ku deklarohen kostot e shpenzuara, të ardhurat dhe përcaktimi i tarifës së shkollimit si dhe kosto financiare mesatare për student[192].<br>Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit të studimit burojnë nga buxheti i shtetit dhe nga tarifa e studentëve dhe *rezulton se institucioni nuk ka paraqitur një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe një plan financiar për mbështetjen dhe mbarëvajtjen financiare të programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor.* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për | Rezulton se plani i financimit është i hartuar në rang intitucional. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore në total për të gjithë programet e studimit që UV ofron, shërbimet operative për mirëmbajtjen, shpenzimet për studime e bursa, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive |

[191] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[192] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.6, Dokumente për menaxhimin e planit financiar", ASCAL, Dok. nr.38. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij. | mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara siç është edhe projekti Teavet i udhëhequr nga DE[193]. |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. | Nga shqyrtimi i RVB rezulton se për hartimin dhe miratimin e projekt buxhetit institucioni fillimisht merr parasysh nevojat e njësive bazë dhe kryesore të institucionit.<br>Raporti financiar realizohet në rang intitucional në mënyrë periodike e cili përban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët si dhe ndarjen e burimeve financiare[194]. |
| **Kriteri 4.** Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. | Sipas Raporti Financiar[195] në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare jo vetëm të një viti akademik por bën një analizë krahasuese të zërave të buxhetit ndër vite dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme të financimit të insitiucionit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin | Bazuar në raportin financiar[196] insittucioni nëpërmjet analizës financiare të vitit akademik pararendës dhe atij aktual paraqet:<br>- Grandi kërkimor nga MARS<br>- Fondet që gjenerojnë nga të ardhurat e universitetit të cilat sigurohen nga tarifat e studimit dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që institucioni ofron. |

[193] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[194] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[195] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[196] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. | *Si rrjedhojë e rënies së ndjeshme, vit pas viti, të numrit të studentëve ky program studimi nuk paraqet qëndrueshmëri të madhe financiare për gjenerimin e të ardhurave për vitin akademik pasardhës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Rezulton se institucioni zbaton procedurat për kriteret e pranimit dhe transferimit bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Asrimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ne Udhëzim Nr.15, datë 26.05.2020, Disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë", i ndryshuar si dhe Udhëzim Nr. 17, datë 30.07.2019, Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin Nr.10, datë 15.05.2019 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë".<br>Gjithashtu instritucioni bazohet tek propozimet e bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik për kutotat[197] dhe kriteret[198]. |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të | Përpapa fillimit të çdo viti akademik institucioni me propozim nga DE dhe miratim nga Senati AKademik dhe MARS[199], harton kriteret dhe procedurat për hyrjen në programin e studimit |

[197] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8. Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[198] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.7. Kriteret e pranimit të studentëve në Programin e Studimit të Ciklit të Parë në DE dhe procedura e pranimit të studentëve të ciklit të parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.17. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor, duke garantuar shance të barabarta për të gjithë kandidatët nëpërmjet shpërndarjes së kuotave për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të veçanta[200], etj. |
| **Kriteri 3.** Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Institucioni harton dhe publikon çdo vit kriteret e pranimit në programet e studimit që ofron UV[201].<br>Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi, transferimet e studimeve si dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe diplomimit përcaktohen në Rregulloren e Programit të Studimit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor[202], Statutin[203] dhe Rregulloren e UV[204]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve. | Rezulton se institucioni harton çdo vit akademik, me propozim të DE dhe miratim nga senati akademik kritere të veçanta sipas legjislacionit në fuqi, për përzgjedhjen e kandidatëve për student.<br><br>*Në faqen zyrtare të UV nuk rezulton të jenë të publikuara kriteret dhe kuotat e pranimit në programet e studimit që institucioni ofron.* |
| **Kriteri 5.** Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi janë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të MARS, si dhe të Maturës Shtetërore.<br>Ne kuotat e propozuara për vitin akademik 2018 -2019 për programin Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor institucioni ka propozuar 1 kuotë për kandidatët nga trojet dhe 1 per studentët e huaj[205]. |
| **Kriteri 6.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun | Përpara pandemisë globale të Covid-19, në kuadër të ditëve të hapura për maturantët UV organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth UV dhe programeve të |

[200] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[201] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[202] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[203] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[204] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[205] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.8, Kuotat e pranimit të studentëve në Programin e Ciklit të Parë Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.18. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | studimit që ai ofron.<br>Kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit, i cili informohet gjithashtu edhe nëpërmjet Fletë Palosjes Informuese për Studentët[206]. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Rezulton se programet e studimit, të detajuara me lëndët dhe modulet që përban, i bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit.<br>Në fillim të vitit akademik studentët familjarizohen me materiale udhëzuese, si:<br>• Rregullorja e Programit të Studimit të Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor[207] përcakton qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin.<br>• Syllabuset[208] e moduleve përkatëse për çdo semester nga lektori i lëndës në të cilat jane te specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti dhe modalitetet e diplomimit të tyre.<br>• Kalendari akademik[209] në të cilin përcaktohen datat e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura si dhe diplomimet.<br>• Fletë Palosja Informuese për Studentët[210].<br><br>*Rekomandohet që institucioni të afishojë në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike dhe gjithashtu të publikojë në faqen e webit të UV sipas fakulteteve përkatëse informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me* |

[206] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[207] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[208] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1- Syllabuset", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[209] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.10, Kalendari akademik i Universitetit 2019-2020", ASCAL, Dok. nr.20. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[210] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| | *kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Nëpërmjet Rregullores e Programit të Studimit të Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor [211] dhe Rregulloren e DE[212] përcaktohen qartë kriteret e shlyerjes së detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin, por nuk studenti gjen informacion të plotë mbi transferimet dhe kualifikimet. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Ne syllabuset[213] e moduleve përkatëse për çdo semestër nga lektori i lëndës janë të specifikuara kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve për çdo modul në veçanti në programin e studimit Mësuesi për Arsimin Parashkollor [214]. |
| **Kriteri 4.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në Rregulloren e Programit të Studimit të Mësuesi për Arsimin Parashkollor, seksioni 8.2/8.3, janë të përcaktuara qartë kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit[215].<br><br>Studentët përfundojnë ciklit e studimeve të tyre bachelor me temë diplome me mesatare mbi 9 ose provim formimi[216], përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit[217], Fondi i pyetjeve të provimit të formimit miratohet nga DE dhe u vihet në dispozicion studentëve në fillim të semestrit të dytë të vitit të tretë akademik[218]. |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të | Përpara pandemisë globale të Covid-19, në kuadër të ditëve të hapura për maturantët UV organizonte me shkollat e mesme të larta në vend takime informuese rreth UV dhe programeve të studimit që ai ofron. |

[211] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[212] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojcw). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[213] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.1- Syllabuset", ASCAL, Dok. nr.11. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[214] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[215] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[216] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.10, Tezat e provimit përfundimtar për mbrojtjen e diplomës Bachelor në (Mësuesi për Arsimin Parashkollor)", ASCAL, Dok. nr.31. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[217] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.1, Rregullore e Programit të Studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor"", ASCAL, Dok. nr.3 (shtojce). Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[218] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.9, Banka e pyetjeve për diplomimin e studentëve në arsimin parashkollor", ASCAL, Dok. nr.30. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi online u informuam se institucioni në fillim të vitit të parë të studimeve DE organizon një takim informues me studentet. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Rezulton që nëpërmjet Statutit të UV[219] studentët mund të informohen për strukturën e institucionit, organizimin, njësitë dhe organet përgjegjëse për marrjen e informacionit për mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt tregut të punës.<br>Komunikimi i brendshëm mes studentëve, stafit akademik dhe sekretarisë mësimore realizohet nëpërmjet UVMS[220].<br>Koordinatori i marrëdhënieve me studentët përcjell informacionin e nevojshëm në lidhje me syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj[221]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Bazuar ne RVB rezulton se studenti mund te aksesoje infromacionin rreth programeve të studimit, lëndëve dhe veprimtarive formuese nëpërmjet njoftimeve dhe udhëzuesve që FSHH publikon, udhëzues dhe infromacione të printuara[222], në website-n e universitetit dhe në platformën UVMS. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për | Nga shqyrtimi i RVB dhe takimi online me Sektorin e Këshillimit të Studentëve dhe Alumnit rezulton se informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe mbështetjen institucionale drejt tregut të punës[223]. Gjithashtu Koordinatori për |

[219] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[220] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[221] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.5, Emërimi i Koordinatorit për marrëdhëniet me studentët", ASCAL, Dok. nr.15. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[222] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.1, Fletë Palosje Informuese për Studentët", ASCAL, Dok. nr.39. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[223] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor, f.64", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| orientimin drejt e në tregun e punës. | marrëdheniet me studentët, ofron për studentët këshillim për zhvillimin e karrierës[224]. |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Përpara pandemisë globale të Covid-19, çdo fillim viti akademik DE organizonte një takim informues me studentët e rinj gjatë së cilës orientoheshin me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ UVMS[225].<br>Nga vizita virtuale e mjedise edhe pse për shkak masave anti Covid-19 studentët nuk ishin prezent, konstatuam se në këndet e njoftimeve përkatëse të fakultetit nuk gjendej informacion fizik për studentët pasi këndet e njoftimeve po rinovoheshin. |
| **Kriteri 5** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance. | Rezulton se nëpërmjet sistemit digjital UVMS, siç pohuan edhe vetë studentët gjatë takimin online të zhvilluar në Zoom, arrijnë të marrin informacion lehtësisht të aksesueshëm edhe në distancë si dhe të ndërveprojnë gjatë realizimit të procesit mësimor. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. | Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore të UV[226]. kostatojmë se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer.<br>Raporti përmban informacione, përveç të tjerash edhe për numrin e studentëve actual dhe e të diplomuarve për çdo program studimi që UV ofron. |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo | Nga shqyrtimi i RVB dhe Rregullorja e FSHH[227], rezulton se sekretaria mësimore është zyra, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët. Sekretaria Mësimore disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si |

[224] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[225] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.6, Vendim Senati nr.101, datë 06.12.2017 Për krijimin dhe funksionimin e UVMS", ASCAL, Dok. nr.27. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[226] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[227] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.5, Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane, FSHH", ASCAL, Dok. nr.10. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | dhe largimet para përfundimit të programit, notës mesatre hyrëse dhe dalëse[228] etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. | Nga takimi online me sekretarinë mësimore konstatuam se ajo administron dhe ruan të dhënat mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor në regjistrin themelar të studentëve, sipas legjislacionit ne fuqi. |
| **Kriteri 4.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Nga takimi virtual rezultoi se sekretaria mësimore e FSHH disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas progameve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen, përfshi edhe temën e diplomimit.<br>Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student të programkit të studimit Bachelor në "Mësuesi Arsim Parashkollor" në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në sistemin e brendshem te informacit UVMS[229]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Nga shqyrtimi i Analizës Vjetore e UV rezulton se institucioni çdo vit akademik, paraqet pranë MASR-së raportet vjetore për veprimtarinë e kryer[230].<br>Sekretaria Mësimore gjithashtu disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit, notën mesatare hyrëse dhe dalëse[231].<br>Institucioni nuk ka paraqitur një raportin analitik periodik mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve.<br><br>*Rekomandohet që institucioni të hartoje raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe për cilësisë e punësimit të tyre, ku, gjithashtu, të evidentojë masat e duhura që institucioni duhet të marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

[228] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Mesatarja ne hyrje dhe dalje", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[229] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[230] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[231] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Mesatarja ne hyrje dhe dalje", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| Standardi V.5<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve. | Bazuar në Rregulloren e UV[232] dhe Statutin i UV[233] rezulton se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik në ogranet kolegjiale të insitucionit:<br>Sipas Rregullores së UV studentët kanë të drejtë të kenë përfaqësues në:<br>- Senatin Akademik me dy anëtarë student duke respektur kuotat e përcaktuara nga legjislacioni ne fuqi.<br>- Në Këshillin e Etikës;<br>Në vitin 2018 është gritur Këshillli Studentor i UV[234].<br><br>*Rekomandohet që Këshilli Studentor të hartojë rregulloren e tij të brendshme sipas legjislacionit në fuqi.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | Institucioni është angazhuar të përfshijë studentët në vlerësimin e procesit akademik, nëpermjet ngritjes së instrumenteve matës për vlerësimin e mësimdhënies[235].<br>Ndërsa përsa i përket përfshirjes se studentëve në vendimmarrje e këshillim *rezulton se institucioni nuk disponon asnjë dokument që të vërtetojë pjesëmarrjen e studentëve në Senatin Akademik.*<br><br>*Gjithashtu, në Grupin e punës ngritur nga NJSBC për hartimin e GVB[236] në kuadër të sigurimit të cilësisë për këtë program studimi konstatuam se nuk është përfshirë një përfaqësues i qeverisë studentore, bazuar në Manualin për "Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit", Ascal 2017.* |
| **Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave | Rezulton se intitucioni gjatë hartimit të programit të studimit Bachelor në Mësuesi për Arsim Parashkollor ka respektuar Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe VKM nr. 41/2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", duke iu përmbajtur ngarkesës mësimore javore në auditor, për leksione, |

[232] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[233] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[234] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Keshilli Studentor", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[235] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[236] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme. | seminare, ushtrime e laboratorë, jo më shume se 25 orë mësimore në javë[237].<br>Sasia mesatare e punës së kryer gjatë një viti studimesh nga një student me kohë të plotë, është 60 kredite ose 1500 orë mësimore punë të studentit për çdo vit akademik. Gjatë vitit të parë studentët zhvillojë 600 orë në auditor dhe 815 orë punë të pavarur; gjatë vitit të dytë studentët zhvillojë 600 orë në auditor dhe 915 orë punë të pavarur dhe gjatë vitit të dytë studentët zhvillojë 720 orë në auditor dhe 781 orë punë të pavarur [238].<br><br>*Konstatohen mospëputhje të shpërndarjes së 1500 orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në Mësuesi Arsim Parashkollor.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. | Bazuar ne Statutin[239] dhe Rregulloren[240] e UV garantohet përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, *por institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të pasqyrojë reflektimet dhe kontributin e tyre në mënyrë të drejtëpërdrejtë në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.* |
| **Kriteri 5.** Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Nëpërmjet instrumentit matës për vlerësimin e mësimdhënies[241] studentëve u krijohet mundësia të japin mendim e tyre mbi cilësinë e zhvillimit të leksionit dhe aftësitë mësimdhënëse të pedagogut.<br><br>*Institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të vërtetojë përfshirjen e studentëve në dhënie mendimi mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | **X** | | |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

237 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.4, Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)", ASCAL, Dok. nr.9. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

238 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.4, Plani Mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese (A-E)", ASCAL, Dok. nr.9. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

239 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

240 Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. | Rezulton se institucioni paraqet procedura të qarta për informimin e studentëve nëpërmjet zyrave përkatëse si sekretaria mësimore, Drejtoria e Edukimit dhe Koordinatori për marrëdhëniet me studentët, i cili luan një rol të rëndësishëm në informimin, këshillimin dhe orientimin e studentëve. Koordinatori asiston sudentët në krijimin e një plan studimi individual dhe kryen verifikimet e domosdoshme për detyrimet që studenti duhet të shlyej[242]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Konstatojmë që nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të UV studentët kanë mundësi të informohen edhe në distancë[243] për mënyrën e regjistrimit të tyre, kryerjen e pagesave online, aksesin në sistem, prenotimin në lëndët që duhet të japin provim. Gjithashtu informacione më të detajuara për profilin e tyre personal, studentët mund te gjejnë në plarformën UVMS[244], ku mund të informohen për provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare. |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Përmes Sektorit të Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it, kandidatët për student, studentët dhe alumni marrin infomacion dhe mbështetje për planifikimin e karrierës se tyre nëpërmjet trajnimeve, forumeve, projekteve, seminareve, takimeve informuese, tryezave të rrumbullakëta, takimeve të studenteve që institucioni organizon.<br>Gjithashtu ajo ofron informacion për bursa, konferenca studimore, informacion në lidhje me mobilitetet dhe progamet e shkëmbimeve jashtë vendit.<br>Institucioni ka në traditë të tij pjesëmarrjen në panairin e përvitshëm Work & Study të organizuar nga MARS[245].<br>Ndërsa, praktikat profesionale zhvillohen në institucione shtetërore, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti i edukimit[246]. |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe | Bazur në rishikimin e RVB konstatojmë se institucioni disponon të dhena për diplomimin e studentëve por nuk disponon të dhëna zyrtare për punesimin dhe cilësinë e punësimit të studentëve të këtij program studimi[247].<br><br>*Rekomandohet që Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it të aplikojë makanizma të ndryshme për gjurmimin e* |

[242] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.2, Vendim për Miratimin e Rregullores së DE", ASCAL, Dok. nr.7. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[243] https://univlora.edu.al/
[244] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.4, Manual për përdorimin e UVMS-Staf/Student", ASCAL, Dok. nr.25. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[245] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 5.3, Raport Panairi Work & Study", ASCAL, Dok. nr.41. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[246] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Dosja e praktikes se studenteve", ASCAL. Parë në Shkurt 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[247] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor, Tabela 23", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | *studentëve pas diplomimit si dhe të ngrejë instrumentet e duhura për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe t'ua vë ato në dispozicion organeve drejtuese përkatëse.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT "BACHELOR"

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Bazuar në Ligjin nr.80, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë[248]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Rezulton se në vitin 2016 institucioni ka ngritur Njësinë e Vlerësimit dhe Sigurisë të Brendshme të Cilësisë së institucionit[249]<br>Konstatojmë se insitutcioni është ende në fazën e hartimin të një draft rregullore për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.<br><br>*Rekomandohet hartimi i një plani strategjik për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë se insitucionit, ku të përfshihen gjithashtu studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet e duhura për | Konstatojmë se institucioni përdor disa instrumente matës për |

[248] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A. Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[249] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 3.1", Vendim i Senatit Akademik të UT "Ismail Qemali, Vlorë, nr.84, datë 12.12.2016 Për ngritjen e NJSBCVI", ASCAL, Dok. nr.22. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | sigurimin e cilësisë siç janë vlerësimet për performancën e stafit akademik[250] dhe pyetësor për studentët[251] për matjen e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktoje përdorim e instrumenteve të duhura për sigurimin e cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit institucional.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit. | Rezulton se institucioni ka hartuar politika dhe procedura të qarta dhe periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Disa nga këto procedura periodike janë:<br>- Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit[252];<br>- Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)[253];<br>- Raporti vetor i UV[254];<br>- Instrumentët matës për vlerësimin e stafit akademik nga ana e studentëve[255] dhe pyetësor për studentët[256] për cilësinë e mësimdhënies:<br>- Strategjia e kërkimit shkencor nga ana e institucionit[257]. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

[250] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[251] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[252] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[253] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[254] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[255] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.3 Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës së stafit ndihmës-akademik,", ASCAL, Dok. nr.44. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[256] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[257] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 4.3 Shkresa për miratimin e Strategjisë së kërkimit shkencor 2017-2022,", ASCAL, Dok. nr.35. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. | Konstatojmë se institucioni ka ngritur në rang njësie bazë grupin e punës për rritjen e cilësisë [258]. |
| **Kriteri 2.** Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. | Rezulton se institucioni harton çdo vit akademik Raportin Vjetor[259] në rang institucioni dhe Plani Stategjik i Departamentit të Edukimit[260] paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. | Nga shqyrtimi i Raportit Vjetor dhe të Vlerësimit të Brendshëm në rang insitucional[261] dhe Planit të masave për përmirësimin e departamentit[262] rezulton se institucioni përdor instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve. |
| **Kriteri 4.** Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Nëpërmjet instrumentave matës për vlerësimin e stafit[263] dhe pyetësor për studentët[264], studentëve u krijohet mundësia të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve nga ana pedagogut përgjegjës.<br>Pas shqyrtimin i Procedurës për Analizën e Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve[265]": rezulton se të dhënat e rezultateve u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. |
| **Kriteri 5.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë. | Institucioni harton çdo vit Raportin Vjetor por në të nuk trajtohen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.<br><br>*Rekomandohet hartimin i Raportit të Vlerësimit të Brendshëm Insitucional, i cili duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme,* |

[258] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[259] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[260] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[261] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[262] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[263] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[264] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca L, Raport mbi rezultatet e pyetsorit studentor për Vitin akademik 2018 -2019", ASCAL, Dok. nr.60. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[265] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike. | Nga shqyrtimi i RVB rezuton se çdo vit akademik, në mënyrë periodike, hartohet Raportin Vjetor i Institucionitt[266] si dhe Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit[267], ku pasqyrohen objektikat dhe synimet për departamentin, studentëte dhe kërkimin shkencor.<br>*Konstatojmë se NJSBCVI harton raportin e analizës së pyetësorëve të studentëve[268] për mësimdhënien, por nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë se kryen në mënyrë periodike vlerësimin e brendshëm të këtij program studimi.* |
| **Kriteri 2.** Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. | Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme si:<br>- Raporti Vjetor i UV [269];<br>- Të dhënat nga instrumentet matës për perfomancen e pedagogut dhe cilësisë së mësimdhënies[270];<br>- Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit[271];<br>- Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit [272]. |

---

[266] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[267] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[268] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[269] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca J, Raporti Vjetor i UV për Vitin 2018- 2019", ASCAL, Dok. nr.58. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[270] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[271] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[272] U Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

<table>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e e rregulluara dhe të tjera.</td><td colspan="4">Rezulton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta, si:<br>• vlerësim i cilësisë së mësimdhënies[273];<br>• vlerësim i performancës së pedagogut[274];<br><br>Institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë realizimin e vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e 73dministrative, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</td><td colspan="4">Institucioni realizon në mënyrë periodike dy pyetësore:<br>1) Për matjen e perfomancës së stafit akademik të përfshirë në këtë program studimi[275],<br>2) Për cilësinë e mësimdhënies[276].<br><br>Rekomandohet që institucioni të zhvillojë sondazhe ose/dhe intervista të alumnit, të personelit akademik e ndihmësakademik si dhe bashkëpunëtorëve të tjerë që kontribuojnë në realizimin e këtij program studim apo/dhe që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</td></tr>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>Nuk përmbushet</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td>X</td><td></td></tr>
</table>

| Standardi VI.4 |
|---|

[273] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.6, Ngirtja e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të sudentënve"", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[274] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[275] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.2, Miratimi i formularit të vlerësimit për matjen e performancës të stafit akademik", ASCAL, Dok. nr.43. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[276] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.1, Procedura e Analizës së Vlerësimit të Pyetësorit të Studentëve", ASCAL, Dok. nr.42. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| **Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Rezulton se departamenti ka hartuar Strategjinë për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit[277] dhe ka ngritur njësinë e sigurimit të cilësisë brenda deparatmentit[278] por institucioni nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument ku të paraqitet veprimtaria e këtij grupi në shërbim të përmirësimit të vazhduar të cilësisë së programit të studimit.<br><br>*Rekomandohet që institucioni të garantojë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë ku të përfshihen aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | Rezulton se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët të cilët janë të angazhuar në GVB për Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të programeve të studimit[279], ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE[280], si dhe ngritja e grupeve mësimore në DE[281] duke garantuar kështu ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. | Rezulton se anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit janë të përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit në rang departamenti dhe fakulteti.<br>Vlerësimi i cilësisë se Departamentit të Edukimit realizohet nga grupi i punë i ngitur në nivel njësie bazë, i përbërë nga 6 anëtar[282]. |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të | Bazuar në Rregulloren e UV[283], Statutin e UV[284] si dhe Rregulloren e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në |

[277] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[278] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[279] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "RVB-Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ASCAL, Dok. nr.1. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[280] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[281] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 2.3", Vendim nr.23, datë 17.01.2017 i DE Për ngritjen e grupeve mësimore në DE", ASCAL, Dok. nr.13. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[282] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.5, Ngritja e grupit të punës së cilësisë, DE", ASCAL, Dok. nr.46. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[283] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca C, Rregullore UV e ndryshuar", ASCAL, Dok. nr.63. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[284] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca A, Statuti i UV", ASCAL, Dok. nr.49. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

| | |
|---|---|
| brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | UV[285] rezulton se institucioni rregullon integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve. |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | Rezulton se nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit që UV ka me institucione të rëndësishme ndërkombëtare[286]si: Universiteti i Leçes, Barit, Mesinës, Perugias, Kozencës (Itali), Liezhit (Belgjikë), Kretës (Greqi), Universiteti i Talin-it (Estoni), Universiteti i Turku-t (Finlandë) Universiteti i Vigo-s, Valencia -s (Spanjë), Universiteti i Nish-it (Serbi), Universiteti i Shkencave Natyrore Sofje (Bullgari), Universiteti i Timisoharës (Rumani), Universiteti i Alesundit (Norvegji) etj.[287] ku pedagogët e Departamentit të Edukimit kanë shkëmbyer përvoja profesionale. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Rezulton se institucioni ka bërë publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. në faqen zyrtare të UV, Statutin, Rregullen, të gjithë vendimet e marra nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. |
| **Kriteri 2.** Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | *Rezulton se institucioni nuk ka paraqitur asnjë dokument që të faktojë publikimin e rezultateve të vlerësimeve të programit të studimit.* |

[285] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca F, Rregullore e Etikës së Kërkimit Shkencor dhe Publikimit në UV", ASCAL, Dok. nr.54. Parë në Janar 2021, gjendet

[286] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca D, Strategjia e Ndërkombëtarizimit", ASCAL, Dok. nr.52. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

[287] Lista e plote e marreveshjeve nder institucionale: https://univlora.edu.al/sektori-projekteve/marreveshje-nderinstitucionale/

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Konstatojmë se instiutcioni ka hartuar në rang njësie bazë Planin e Masave[288] dhe Stategjinë për Zhvillimin e Departamentit[289], të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara për departamentin, studentet dhe aktivitetin kërkimor-shkencor të stafit akdemik dhe studentor. |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë nëpërmjet Planit të Masave të marra nga departamenti[290] dhe përmirësimin e vazhdueshëm të instrumenteve të vlerësimit për përmirësimin e mësimdhënies[291]. |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga shqyrtimi i RVB dhe diskutimet e realizuara nga takimet online me NJSBC rezultoi se institucioni organizon takime periodike me stafin akademik, ndihmës dhe studentët për t'i informuar për arritjet dhe rekomandimet që duhet të plotesojë institucioni për rritjen e cilësisë së institucionit në tërësi dhe programeve të studimit, në veçanti. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

[288] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[289] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 1.3, Strategjia për Zhvillimin e Departamentit të Edukimit (2017 -2022)", ASCAL, Dok. nr.8. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[290] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.4, Plan masash për përmirësimin e cilësisë së Departamentit", ASCAL, Dok. nr.45. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq
[291] Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, FSHH, DE, "Evidenca 6.6, Ngirtja e grupit të punës për përmirësimin e pyetësorit të sudentënve"", ASCAL, Dok. nr.47. Parë në Janar 2021, gjendet në: https://ascal.al/sq

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" të Institucionit të Arsimit të Lartë "Ismail Qemali" Vlorë.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" ka mbi 18 vite akademike që zhvillohet në këtë institucion.

2. Programi Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" zbaton akte normative konform ligjit të arsimit të lartë dhe akteve nënligjore të MASR, por dhe ato të hartuara nga vetë UV.

3. UV ka infrastrukturë fizike, ndihmëse, plaftormë online që lehtëson zbatimin e programit, por dhe kërkesat e nevojat e studentëve. Rezulton se nëpërmjet UVMS institucioni garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ.

4. Fakulteti i Edukimit ka kapacitet infrastruktoror dhe hapësira të plota për akomodimin e studentëve të programit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", duke përmbushur kështu standardet e kapacitetit infasrtukturor për student.

5. Institucioni ka realiuar marrëveshje bashkepunimi me Bashkinë e Vlorës për krijimin e kushteve për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike të cilat janë thelbësore për ketë program studimi.

6. Institucioni harton çdo vit akademik Raportin Vjetor në rang institucioni dhe Plani Stategjik i Departamentit të Edukimit paraqitet një analizë për përdorimin e mekanizmave për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.

**Pika të dobta**

1. Ne Programin e Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" u konstatua se mungojnë disiplinat të cilat i pajisin studentët me dije dhe kompetenca nga fusha e Shkencave të Natyrës.

2. Konstatohen mospëputhje të shpërndarjes së 1500 orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".

3. Në Rregulloren e Programit të Studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor" mungojnë objektivat për formimin e studentëve. Gjithashtu, nuk tregohen dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit.

4. Rezulton, se në UV nuk ka në qarkullim udhëzues (apo manuale) që normojnë shkrimin e një teme diplome prej fillimit të saj e deri në përfundimin dhe paraqitjen përpara komisionit.

5. Rezulton se institucioni nuk disponin asnjë laborator të teknologjisë së infomacionit në rang fakulteti e universiteti.

6. Institucioni nuk disponon një rregullore të brendshme për funksionimin e Këshillit Studentor.

7. Rezulton se institucioni nuk disponon instrumente të qarta për gjurmimin e studentëve pas diplomimit si dhe për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit.

8. Institucioni nuk disponon një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor.

**Rekomandime**

1. Rekomandohet që të rishikohet plani mësimor i këtij programi studimi, me qëllim integrimin e lëndës "Njohuri bazë për Shkencat e Natyrës", ku te parashikohen gjithashtu dhe orët laboratorike, te cilat duhet të kenë një peshë të përcaktuar qartë në përmbajtjen e programit të lëndës.

2. Rekomandohet te rishikohet shpërndarja e orëve mësimore punë të studentit, çdo vit akademik, në plan programin e Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", sipas legjislacionit ne fuqi.

3. Rekomandohet që të bëhet plotësimi i Rregullores së Programit të studimit "Bachelor" në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor", ku në të të parashikohen: objektivat e programit të studimit; dijet, aftësitë, si edhe kompetencat profesionale që fitohen nga studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit.

4. Rekomandohet hartimi i udhëzuesve (apo manualeve) që do të shërbejnë si udhërrëfyes për studentët për zhvillimin e temave të diplomës.

5. Rekomandohet që institucioni të hartojë raporte analitike periodike mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve ku të evidentojë masat e duhura që institucioni duhet të marrë në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.

6. Rekomandohet që institucioni të sigurojë për studentët të paktën një laborator të teknologjisë së infomacionit të pajisur me programe profesionale në shërbim të programit të studimit Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Parashkollor".

7. Rekomandohet që Këshilli Studentor të hartojë rregulloren e tij të brendshme sipas legjislacionit në fuqi.

8. Rekomandohet që Sektori i Këshillimit të Studentëve dhe Alumn-it të hartojë strategji dhe te aplikojë makanizma të ndryshëm për gjurmimin e studentëve pas diplomimit si dhe të ngrejë instrumentet e duhura për mbledhjen dhe përpunim e të dhënave për cilësinë e punësimit të studentëve të këtij program studimi.

9. Rekomandohet që institucioni të hartojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit Bachelor në Mësuesi për Arsimin Parashkollor.

**Conclusions of the Evaluation of the of the Bachelor program in "Teacher for Preschool Education" of the Higher Education Institution "Ismail Qemali" Vlora.**

### Strengths and affirmations

1. The Bachelor program in "Teacher for Preschool Education" has been taking place in this institution, for over 18 academic years.
2. The Bachelor program in "Teacher for Preschool Education" implements normative acts in accordance with the law of higher education and bylaws of MoESY, but also those drafted by UV itself.
3. UV has physical infrastructure, auxiliary, online platform that facilitates the implementation of the program, but also the requirements and needs of students. It turns out that through UVMS the institution guarantees real-time monitoring of academic and administrative activity.
4. The Faculty of Education has infrastructural capacity and full space for accommodation of students of the Bachelor program in "Teacher for Preschool Education", thus meeting the standards of infrastructural capacity per student.
5. The institution has realized a cooperation agreement with the Municipality of Vlora for the creation of conditions for the development of professional practices and other practical activities which are essential for this study program.
6. The institution compiles every academic year the Annual Report at the level of the institution and the Strategic Plan of the Department of Education presents an analysis of the use of mechanisms for the review, approval and occasional supervision of undergraduate study programs.

### Weak points

1. In the Bachelor program in "Teacher for Preschool Education" it was found that there is a lack of disciplines which provide students with knowledge and competencies in the field of Natural Sciences.
2. There are discrepancies in the distribution of 1500 teaching hours of student work, each academic year, in the Bachelor program in "Teacher for Preschool Education".
3. In the Regulation of the Study Program "Bachelor" in "Teacher for Preschool Education" are missing the objectives for the formation of students. Also, it does not reflect the knowledge, skills, as well as professional competencies that students should acquire at the end of the study program.

4. Results that in UV there are no guides (or manuals) in circulation that regulate the writing of a diploma thesis from its beginning to its completion and presentation before the commission.
5. Results that the institution did not have any information technology laboratories at the faculty and university level.
6. The institution does not have an internal regulation for the functioning of the Student Council.
7. Results that the institution does not have clear instruments for tracking students after graduation as well as for collecting and processing data on the quality of employment of students in this study program.
8. The institution does not have a detailed plan for increasing the number of library items in support of the Bachelor program in Teacher for Preschool Education.

**Recommendations**

1. It is recommended to review the curriculum of this study program, in order to integrate the subject "Basic knowledge of Natural Sciences", which also provides laboratory hours, which should defined weight in the content of the course program.
2. It is recommended to review the distribution of working hours of the student, every academic year, in the Bachelor program in "Teacher for Preschool Education", according to the legislation in force.
3. It is recommended to complete the Regulation of the study program "Bachelor" in "Teacher for Preschool Education", which provides: the objectives of the study program; knowledge, skills, as well as professional competencies acquired by students upon successful completion of the study program.
4. It is recommended to compile guides (or manuals) that will serve as guides for students to develop diploma topics.
5. It is recommended that the institution compiles periodic analytical reports on the quality of incoming and outgoing students where it identifies the appropriate measures that the institution should take towards improving these indicators.
6. It is recommended that the institution provides for students at least one information technology laboratory equipped with professional programs in service of the Bachelor study program in " Teacher for Preschool Education".
7. It is recommended that the Student Council drafts its internal regulations according to the legislation in force.
8. It is recommended that the Student Counseling and Alumn Sector develop strategies and apply various mechanisms for tracking students after graduation as well as establish appropriate tools for collecting and processing data on the quality of student employment of this study program.

9. It is recommended that the institution draw up a detailed plan for increasing the number of library items to support the Bachelor program in Teacher for Preschool Education.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | X | |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | X | |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE | | | X | |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | X | |